



NË SHËRBIM TË STUDENTËVE DHE KOSOVËS

Akreditimi për tri vite i UBT-së dhe i programeve, anëtarësimi në...**F02**

STUDIMET THEMELORE NË UBT, MASTER NË TU WIEN

Yllza Luftiu dhe Erden Halili studimet themelore kanë përfunduar...**F03**

NË UBT PREZANTOHET SHKENCA

Menaxhmenti i lartë i Universitetit për Biznes dhe Teknologji...**F28**



UBT FILLON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETE NË REPUBLIKËN E TURQISË

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), në vazhdimësi po...**F03**

ASTRITIN E KAM PROFESOR DHE PUNËDHËNËS

Studentët e UBT-së, përveç që ndjekin procesin mësimor ata kanë edhe ba...**F010**

PROCESI I PRIVATIZIMIT NË KOSOVË DHE EFEKTET E TIJ

Siç dihet, Kosova pas vitit 1999 gjendet në fazën e tranzicionit, e cila ballafaqohet me ...**F028**



ME TO KEQ, PA TO KEQ !

"Me men n'kry e me sy n'ballë qikat e sotit n'pike t'ditës hypin 20 cantin mi tokë. Jaaaa...**F022**

Mirë se vini në botën universitare!

"Mbi 200 profesorë dhe ekspert nga katër kontinente e Botës, mbi dyzet vende dhe kultura të ndryshme, mbi 50 universitete dhe kompani me renome botërore, kanë sjell dhe po sjellin dijen e tyre në programet ku edhe ju studentë do të studioni", tha presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë fjalimit të mbajtura para studentëve të rinj, në ceremoninë solemne të organizuar për fillimin e vitin të ri akademik 2010/1011.



UBT-ja e çoi mesazhin në botë

"Në goftë se i marrim në konsideratë zhvillimet shkencore dhe teknike, kualitete e jetës do të ishte gjithnjë më i mirë. Por, siç po shihet, është shumë vështirë të krijohet një strukturë shoqërore që do të mundësonte zhvillimin e këtyre përparësive", ka deklaruar presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, duke shtuar se në botë ka një zhvillim të madhe dhe të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë, atë masë sa njerëzimi nuk e ka përjetuar në herët.



Editorial

Sukseset në vitin 2010 dhe synimet për vitin 2011 të UBT-së

Në shërbim të studentëve dhe Kosovës



EDMOND HAJRIZI
President i UBT-së

Akreditimi për tri vite i UBT-së dhe i programeve, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, partneriteti me universitete evropiane, organizimi i konferencave të karakterit shkencor ndërkombëtar, publikimet shkencore, projektet profesionale, rritja numrit të studentëve, diplomimi i shumë kuadrove në nivelin master dhe bachelor, projekti TEMPUS dhe projekti ERASMUS MUNDUS me 16 universitete nga Evropa, janë disa prej arritjeve, që e karakterizojnë vitin 2010 në UBT. UBT-ja ka pasur një rritje të numrit të ri të studentëve në krahasim me vitin e kaluar gati 100 për qind. Kjo do të thotë se interesimi për të studiuar në UBT po rritet në vazhdimësi çdo vit.

Vlera më e madhe që UBT-ja ka, është punësimi dhe karriera e suksesshme e tyre. Ne do të vazhdojmë ta ruajmë këtë trend duke u angazhuar edhe më tutje në formimin e vlerave të mirëfillta profesionale dhe shkencore, të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin e kuadrove që kërkohen në tregun e punës sot dhe nesër në vend dhe më gjerë.

Për vitin e ardhshëm kalendarik, përkatësisht akademik, projektet që planifikohen të realizohen nga UBT-ja janë: Projekti i Kampusit të ri Universitar; Fillimi i zbatimit të Projektit ERASMUS Mundus; Organizimi i Konferencave dhe aktiviteteve shkencore; Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar (shkëmbimi i studentëve dhe profesorëve); Rritja e numri të studentëve dhe Ngritja e kapaciteteve akademike vendore.

UBT-ja deri më tash ka organizuar një seri aktiviteteve të rëndësishme akademike dhe shkencore. Konferenca me karaktere shkencore, forume, vizita studimore jashtë vendit por edhe projekte hulumtuese shkencore dhe profesionale.

Këtë vit e kemi organizuar Konferencën ndërkombëtare SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability, e cila ka qenë e nivelit botëror. Është obligim yni, por edhe kënaqësi që ne si institucion i arsimit të lartë dhe si Kosovë kemi pas mundësi ta organizojmë konferenca dhe ngjarje të rëndësishme shkencore botërore këtu në Kosovë. SWIIS ishte po ashtu një ngjarje shkencore ndërkombëtare e organizuar nga UBT-ja. Kjo konferencë e ka futur Kosovën edhe më shumë në kuadër të vendeve në të cilat punohet dhe gjenerohet edhe shkencë.

Kampusi është njeri prej projekteve më të mëdha që është duke e zhvilluar UBT-ja. Besoj se 10 vjetorin e aktivitetit tonë në Kosovë do ta realizojmë në Kampusin e ri universitar.

Urime festat e fundvitit !

Presidenti i UBT-së,

Prof. Dr. Edmond Hajrizi



— I M P R E S U M —

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së.
KRYEREDAKTORE: Naile Demiri
REALIZIMI TEKNIK: Herolind Beqaj
ADRESA: www.ubt-uni.net



UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) fillon bashkëpunimin me Universitetin Kadir Has dhe Universitetin Amir Sinan

UBT fillon bashkëpunimin me Universitete në Republikën e Turqisë

Prishtinë, Dhjetor 2010 –

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), në vazhdimësi po bashkëpunon me Universitetet e njohura botërore, për bartjen dhe shkëmbin e përvojave në fushën universitare.

Një bashkëpunim të tillë e ka filluar edhe me Universitete nga Republika e Turqisë.

Një delegacion nga Universiteti UBT nga Kosova, i prirë nga Presidenti i Universitetit UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka qëndruar për vizitë disa ditore në Turqi, gjegjësisht kanë vizituar Universitetin 'Kadir Has dhe Universitetin 'Amir Sinan', dhe kanë takuar menaxhmentin e lartë të universiteteve të cekura më lartë si Rektorët, Dekanët dhe Profesorët, me të cilët është diskutuar fillimi i bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore në mes të këtyre Universiteteve.

Është diskutuar mjaft shumë edhe për zhvillimin e korrikulave, mobilitetin e stafit akademik dhe të studenteve,



organizimin e eventeve shkencore në nivel regional dhe ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrje të përbashkëta në projekte evropiane.

"Natyrisht, ishte një shkëmbim shumë i mirë përvojash për ne, sepse këto Universitete vërtetë kanë bërë një zhvillim të madh dhe kanë krijuar emër në

fushat e studimeve të cilat ato i ofrojnë. Prandaj, është interes i yni që praktikat e mira turke të barten edhe në Kosovë", tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Pritet që në ditët në vijim një delegacion nga këto Universitete ta vizitojnë edhe Kosovën, gjegjësisht UBT-në.

Studimet themelore në UBT, Master në TU WIEN



Yllza Luftiu dhe Erden Halili studimet themelore kanë përfunduar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinore. Pas mbarimit të këtyre studimeve Yllza dhe Erdeni menjëherë shfaqën interesime për studime Master jashtë kufijve të Kosovës, pikërisht në krye-

qendrën e Austrisë, në Vjenë, në Universitetin TU WIEN, në Departamentin e Arkitekturës.

"Vlen të veçohet, se dëshira jonë për studime të mëtutjeshme është realizuar në bashkëpunim me profesorët ndërkombëtarë, pikërisht me ata të Vjenës", tha Yllza Luftiu për gazetën "UBT News".

Studentët nga SHBA vizituan Kosovën

Studentët amerikanë për vizitë akademike zgjedhën UBT-në

Prishtinë, 5 tetor 2010 –

Një grup prej 25 studentësh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe tre profesorë nga Danimarka, përkatësisht nga "Instituti Danez për studime jashtë vendit", krahas aktiviteteve tjera që zhvilluan nëpër institucionet e Kosovës si EULEX, OSBE, OJQ, etj, për vizitë akademike kanë përzgjedhur Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Gjatë kësaj vizite, studentë nga SHBA dhe 20 studentë të UBT-së, ndoqën edhe një ligjëratë të Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizin me temën "Zhvillimet dhe ngeçjet pas luftës së fundit në Kosovë".

Studentët amerikanë edhe studentët kosovarë, pas ligjëratës ishin të lejuar t'i parashtronin pyetje të ndryshme njëri tjetrit dhe të debatonin për temën e ligjëruar nga presidenti i UBT-së, E. Hajrizi.

Njëri prej studentëve nga



Amerika parashtrori pyetjen: Sa të rëndësishme janë organizatat nga SHBA apo Evropa në zhvillimin dhe ngritjen e popullit kosovar në të gjithë sektorët?

Pastaj u debatua shumë për qeverisjen aktuale dhe sa ndikon ajo në rritjen, zhvillimin

dhe integrimin në Unionin Evropian.

"UBT ka qenë, është dhe do të mbetet gjithmonë si Universiteti me renome dhe me vlera të larta në vend si dhe do të jetë gjithmonë mikpritës dhe dyer hapur për të gjithë ata që dëshirojnë ta vizitojnë, të stu-

diojnë, të dinë më shumë rreth këtij institucioni, qofshin ata miq nga SHBA, Evropa, Kosova, Shqipëria e kudo tjetër. UBT gjithmonë do t'i mirëpresë me kënaqësinë dhe nderin më të madh", tha Lirigzona Morina, studente në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe

Ekonomi në UBT.

Studentët kosovarë dëshironin të dinin më shumë për mënyrën dhe kulturën e arsimit në SHBA apo Danimarkë si dhe anasjelltas.

Përveç tjerash, studentët vizituan edhe objektin e UBT-së. Vizita kryesisht u përqendrua te Laboratori i Mekatonikës, Bibliotekë etj.

Me ta mbyllur ligjëratën, studentët e të dyja vendeve të shoqëruar nga Presidenti i UBT-së, z. Edmond Hajrizi dhe udhëheqës të tjerë, së bashku darkuan në restorantin "Pisha", në Prishtinë, ku vazhduan edhe më tej shoqërimin dhe ndarjen e shumë eksperiencave së bashku.

Përzgjedhja për vizitën e UBT-së është bërë në bazë të performancës së shkëlqyeshme që ka treguar UBT-ja në drejtimin e studimeve "Shkenca Politike dhe Diplomacia", për të cilën kanë dëgjuar udhëheqësit e këtij projekti në veçanti znj. Neringa Bigailaitë.

UBT-ja organizoi ceremoni solemne për fillimin e vitit të ri akademik

Mirë se vini në botën universitare!

“Mbi 200 profesorë dhe ekspert nga katër kontinente e Botës, mbi dyzet vende dhe kultura të ndryshme, mbi 50 universitete dhe kompani me renome botërore, kanë sjell dhe po sjellin dijen e tyre në programet ku edhe ju studentë do të studioni”, tha presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë fjalimit të mbajtura para studentëve të rinj, në ceremoninë solemne të organizuar për fillimin e vitin të ri akademik 2010/1011.



Prishtinë, 1 tetor 2010-

Universiteti për Biznes dhe Teknologji UBT, vitin e ri akademik 2010/2011 për studentët brucoshë (viti i parë), dhe për studentët aktual zyrtarisht e fillo të premtën, më 1 tetor 2010.

Në ceremoni morën pjesë, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Zëvendëspresidenti z. Derek Shields, dekanët e fakulteteve, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre.

Rectori i UBT-se, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u ka dëshiruar mirëseardhje studenteve të rinj në botën akademike universitare, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë dijet e reja,

rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmoj me te gjitha kapacitetet e tij.

Një fjale rasti në këtë ceremoni, ndërlihdur me punën hulumtuese dhe studimore dhe rezultatet e arritura në UBT, ka mbajtur edhe Zëvendëspresidenti z. Derek Shields.

Ne ceremoninë e pritjes së studentëve të rinj me një fjalë është

paraqitur edhe Prof. Dr. Musa Limani, profesor në UBT dhe Dekan për Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi. Ai ka përkujtuar se për studime në këtë drejtim janë përcaktuar një numër i madh i studenteve të rinj, me të cilët do të punojnë një numër i madh profesorësh vendore e ndërkombëtare, eksperte të kësaj fushe,

ndërkohë që studentet do të kenë në dispozicion salla, kompjuter. Po kështu, si një faktor shumë pozitiv, ai përmendi edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani te rëndësishme në vend, që do të mundësojnë zhvillimin në nivel sa më të mirë të punës praktike të studenteve.

Fjalimi i Presidentit z. Edmond Hajrizi drejtuar studentëve të rinj të UBT-së

**Të nderuar studentë,
Të nderuar prind dhe familjarë,
I nderuar staf akademik dhe menaxherial i UBT-së,
Të nderuar përfaqësues të medieve**

Natyrisht që ne jemi shumë të nderuar që sot ju kemi juve këtu e cila është njëra prej momenteve më të veçanta për fillimin e karrierës akademike.

Ky është viti i tetë që UBT-ja organizon një ceremoni të tillë për fillimin e vitit të ri akademik.

Ceremoni të tilla të organizuar në vazhdimësi, del si rezultat i punës së palodhshme me një

program modern që UBT-ja e ka filluar me vite, duke u bazuar në standarde evropiane dhe amerikane të studimeve po edhe në bazë të nevojave dhe kërkesat që dalin nga tregu i punës.

Kjo ceremoni sot ekziston falë vendimit të juaj që Ju të jeni pjesë e këtij institucioni.

Kjo ceremoni del si përkushtim për të studiuar dhe për të ndërthurur një dije dhe personaliteti liderë në njërin prej profesioneve të zgjedhura nga ju, me qëllim të arritjes së një cilësi më të lartë jetësore për ju dhe shoqërinë e tonë.

UBT me një ambient unik në Kosovë

Mbi 200 profesorë dhe ekspert nga katër kontinente e Botës, mbi dyzet vende dhe kultura të ndryshme, mbi 50 universitete dhe kompani me renome botërore, kanë sjell dhe po sjellin dijen e tyre në programet ku edhe ju studentë do të studioni.

Natyrisht në UBT është krijuar një ambient unik në Kosovë, një ambient ndërkombëtar, ndërkulturorë, interdisiplinar,





Nuk mjafton të jesh vetëm profesionalistë i mirë por të jesh edhe proaktiv me ide të mira me kreativitet me një shkalë të lartë inovacioni që dhe e dallon njeriun e suksesshëm.

Ndërton partneritete me të tjerët me kuptuar se vetëm nuk mund të besh shumëçka sidomos në këtë zhvillim global, prandaj juve ju duhen partner vendorë, ndërkombëtarë, dhe kolegial etj. Ndaj ju keni hapësirë të krijoni partneritete sepse e ndihmoni veten dhe shoqërinë por mos mendoni vetëm për vete por edhe ndieni një përgjegjësi ndaj shoqërisë, si personalitete.

Puna juaj bazohet në fakte dhe rezultate, nëse kemi rezultat gjatë studimeve atëherë ne jemi të suksesshëm.

UBT-ja do të merë një përgjegjësi dhe obligim që t'ju ofroj vegla, informacione dhe hapësirë e nevojshëm për të marrë vendime racionale që ju garantojnë juve vlera më të larta ndërkombëtare, pikërisht vlera që konsiderohen vlera në të

mirëfillta në globin tokësor.

Detyra ime dhe e UBT-së në përgjithësi është që ti ofrojmë studentit të gjitha informacionet e shkencës nga ekonomia, menaxhmentit, teknologjitë ma moderne në robotikë, arkitekturë dhe planifikim hapësinorë, dizajn, juridik, mardhënie ndërkombëtare, integritime evropian dhe kompetencën sociale.

Natyrisht kjo është mundësuar edhe për gjenerata e kaluara por do mundësohet edhe për ju falë punës së palodhshme stafit dhe partnerëve të UBT-së.

Ne kemi pas sukses të theksuar gjatë këtyre viteve dhe kjo na ka motivon ta vazhdojmë pandërprerë edhe në vitet në vijim.

Studentë të rinj ne presim prej juve që ti bashkoheni sloganit "Top Education for Top Students", dhe saktësisë "Witha Quality"

Angazhimi i madh i studentëve në UBT dhe argumentet e shumta të cilat i kanë paraqitë

për nivelin e zhvillimit të UBT-së, mbështetur në programe studimore të anëtarësuar edhe në mekanizma ndërkombëtar UBT ka dal të thyej bllokada të shumta duke u shëndrruar në ambasador të vendit tonë, për prezantimin e vlerave të shumta ekzistuese dhe synimeve të vendit tonë, për prezantimin e trendëve më bashkëkohore në shkencë dhe teknologji duke i bindur të gjithë të tjerët se në Kosovë ka vërtetë vlera që duhet çmuar dhe përkrahur se studentët kosovarë mund të përfaqësohen denjësisht në të gjitha rrethet kulminante shkencore në Botë.

Natyrisht ne presim prej juve, dmth studentëve të UBT-së, që ti bashkoheni sloganit "Top Education for Top Students", dhe saktësisë "Witha Quality"

Të keni një karrierë të suksesshme, prestigj, sukses dhe cilësi, më këtë e ndihmoni vetëve në rënd të parë dhe po ngritin vlerat për vendin tuaj.

Të nderuar studentë dhe koleg,

Në po përiqemi të jemi universiteti numër një në Kosovë, ruajtjen e kësaj pozitë kulminante nuk e shohim si synim por edhe si përgjegjësi ndaj jush.

Cilësia në UBT mbete mbi të gjitha, programet tona të studimeve janë në përputhje të plotë dhe të gjitha standarde evropian dhe amerikane që i shohin në akreditim dhe sistemi i menaxhimit të UBT-së.

UBT prej 2006 funksionon prej sipas standardit ndërkombëtar për cilësi ISO 9001, organizatë që të garanton siguri të cilësisë konform standardeve.

I falënderoj të gjithë partnerët, stafin akademik dhe menaxherial për punën e tyre të palodhshme për suksesin e deritashëm.

Të nderuar studentë,

Besoje se do shihem në ceremoni të tjera.

Urime dhe suksese gjatë studimeve.

dhe kjo i ka krijuar UBT-së një mundësi për programe dhe studime dhe projekte që nuk kanë qenë në shumicën e rasteve më parë të ofruar fare në Kosovë.

Është një qëllim që kemi ne dhe që kanë studimet e UBT-së e kjo është të zhvillojmë një personalitete që të jetë i përgatitur në tregun e punë.

Studentë të nderuar, mos mendoni vetëm për vete por edhe për shoqërinë dhe vendi tonë

Mirë se vini në universin akademik !

Prishtinë, 24 nëntor 2010

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), vitin e ri akademik 2010/2011 për studentët e studimeve master (viti i parë), zyrtarisht e filloi më 24 nëntor 2010, dhe më këtë rast organizoi ceremoni solemne të mbajtur në hollin e

objektit të universitetit në fjalë.

Në ceremoni morën pjesë, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Zëvendëspresidenti z. Derek Shields, dekanët e fakulteteve, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre.

Rektori i UBT-se, prof. dr.

Edmond Hajrizi, u ka dëshiruar mirëseardhje studenteve të rinj në botën akademike universitare, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë dijet edhe me të reja, rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmojë me të gjitha kapacitetet e tij.



UBT organizoi konferencën ndërkombëtare në nivel botëror me temën "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability"

UBT-ja e çoi mesazhin



"Në qoftë se i marrim në konsideratë zhvillimet shkencore dhe teknike, kualitete e jetës do të ishte gjithnjë më i mirë. Por, siç po shihet, është shumë vështirë të krijohet një strukturë shoqërore që do të mundësonte zhvillimin e këtyre përparësive", ka deklaruar presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, duke shtuar se në botë ka një zhvillim të madhe dhe të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë, atë masë sa njerëzimi nuk e ka përjetuar në herët.

Prishtinë, 27 tetor 2010 – Në vazhden e ngjarjeve dhe konferencave me karakter ndërkombëtar, të organizuara në vazhdimësi nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, në këtë universitet ka nisur konferenca treditore ndërkombëtare me temën "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability" ose "Gjeta e rrugëve shtesë për stabilitetin ndërkombëtar".

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, pas hapjes solemne të punimeve të konferencës, ka thënë se njerëzimi kurrë nuk ka jetuar më mirë se sot, megjithëse në të njëjtin kurrë nuk ka pasur diferencë më të mëdha në mes të sistemeve shkencore, shoqërore dhe teknike. "Në qoftë se i marrim në konsideratë zhvillimet shkencore dhe teknike, kualiteti i jetës do të ishte gjithnjë më i mirë. Por, siç po shihet, është

shumë vështirë të krijohet një strukturë shoqërore që do të mundësonte zhvillimin e këtyre përparësive", ka deklaruar z. Hajrizi, duke shtuar se në botë ka zhvillim të madhe e të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë në atë masë sa njerëzimi nuk e ka përjetuar në herët. "Ne sot po kërkojmë një model që do të përfshinte të gjithë trendet e zhvillimit, si p.sh, jemi duke e kërkuar "të menduarit e orientuar në sistem", për të menduar

në qasje ndaj sistemit, biznes exellence, sistemin e integruar të menaxhmentit, menaxhimin risikut, inovacioni, zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin e sistemeve dhe përgjegjësin shoqërore", ka deklaruar Hajrizi.

Zëvendëspresidenti i UBT-së, Derek Shields, ka folur në pika të shkurtra për rendësin e zhvillimeve teknologjike, shkencore dhe shoqërore për stabilitetin ndërkombëtar.

Konferenca që mbledhi shkencëtarë, ekspert, hulumtues dhe profesorë të kësaj fushe nga institucionet ndërkombëtare, partnere të UBT-së, si dhe ekspertë vendorë të kësaj fushe.

Peter Kopacek nga Universiteti i Vjenës e Teknologjisë, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e konferencës dhe tha se jam i nderuar ta hapi SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for



në botë



Improving International Stability".

"Arsyeja pse e kemi organizuar këtë konferencë në Kosovë është se në vitin 1983 kemi krijuar komitetin teknik për stabilitetin ndërkombëtar dhe njëri ndër qëllimet është të organizoj konferenca në shtete e reja.

Para tri vite patëm vendosë që konferencën ta organizojmë në Kosovë, si shtete i ri dhe që atëherë kemi pas të drejtë.

Për tri ditë me radhë në konferencë do prezantohen 31 punime shkencore nga 13 shtete të ndryshme. Njëri ndër qëllimet e IFAC është tu ipet rasti hulumtuesve të rinj ti prezantojë punimet shkencore", tha z. Kpacak.

Në tre sesionin e konferencës u prezantuan një varg të arriturash nga hulumtimet shkencore të pjesëmarrësve të konferencës. Sesioni i parë "Zhvillimi dhe qëndrueshmëria në mjedisit", e kryesoi Peter Kopacek nga Austria. Në këtë sesion u paraqitën tre hulumtime. Për hulumtimin "Kontributi i UBT për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës" folën Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi nga Kosova, Lery Stapleton nga Irlanda dhe Peter Kopacek nga Austri. F.

Kaltseis nga Austri prezantoi hulumtimin "Mjete dhe metodat në zhvillimin e produktit për të redaktuar ndikimin e mjedisit". Peter Kopacek dhe Ilir Rexha prezantuan hulumtimin "Menaxhimi i mbeturinave elektronike në Kosovë".

Sesioni i dytë "Modelimi dhe stimulimi" udhëheqës i sesionit në fjalë ishte G. Feichtner nga Austria. Një hulumtim paraqiti Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Fatos Bakalli dhe Dr. Bekim Gashi, dhe një hulumtim N. Chivarov, nga Bullgaria.

Sesioni i tretë "Menaxhimi në Shërbimin e Stabilitetit", ku e kryesoi M. Hersh nga Skocia. Në këtë sesion punimet i paraqitën O. Zavlani, M. Braneshi nga Shqipëri, me temën "Transferimin e teknologjisë dhe sistemet e automatizimit, ndërtimi në Shqipëri".

N. Jesse nga Gjermani, foli për hulumtimin "Teknologjia dhe qendra teknologjike në Dortmund". Arton Celina "Orkestrim në shërbimin e inxhinierisë të programuar". M. Temraz nga Egjipti "Strategjitë praktike në industrinë e telekomit në kohë të vështira".

Konferenca në fjalë është organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës dhe Teknologjisë, Institutin për Pajisjet dhe Trajtimin e Robotikës (IHRT). Kjo konferencë është kaptinë e konferencave të Federatës Ndërkombëtare e Kontrollit Automatik (IFAC)

IFAC është themeluar në 1956 dhe momentalisht ka 50 shtete antare, dhe antari më i ri i federatës është Kosova, që është anëtarësuar përmes Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), është e nderuar, të jetë nikoqire e konferencës në fjalë, në bashkëpunim me partneret ndërkombëtare, për të organizuar konferencë të këtij niveli më këtë rast me Institutin për Pajisjet dhe Trajtimin e Robotikës (IHRT), Universitetin e Vjenës e Teknologjisë.

Punimet e konferencës vazhduan edhe më 28 dhe 29 tetor 2010, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prishtinë.

Pjesëmarrësit e konferencë në fjalë më pas vizituan edhe disa qytete të Kosovës.



Kosova ka mungesë të disa bizneseve

Vazhdon bashkëpunimi UBT- MFSK



Prishtinë, 8 tetor 2010- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), vazhdoi bashkëpunimin me Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Në organizim të Departamentit

Civilo-Usharak, në Kosovë. Momedrandumin e nënshkruan presidenti i UBT-së, Prof . Dr. Edmond Hajrizi dhe në emër të Ministrisë së FSK-së, memorandumin e mirëkuptimit e ka nënshkruar Sekretari Përgjithshëm z. Shkëlzen Syla.

Qëllimi i Memorandumit të mirëkuptimit është bashkëpunimi në mes të këtyre institucioneve, UBT – së dhe

MFSK-së, të cilat do t'i mbështetin reciprokisht aktivitetet për realizimin e misioneve të tyre, të bazuara në politikat e Ministrisë së FSK-së dhe të Kolegjeve Universitare

të Kosovës.

Në bazë të këtij memorandumi mirëkuptimi, MFSK-ja do të angazhoj personelin e saj, në fushat për të cilat palët nënshkruese ranë dakord, ndërsa UBT-ja do të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të MFSK-së dhe FSK-së, me programet arsimore.

Gjithashtu UBT do ta mbështes në vazhdimësi MFSK-në, me stafin e saj akademik, në hartimin e programeve strategjike, në mbajtjen e ligjëratave të kohëpaskohshme për temat e caktuara, si dhe aftësimin profesional të kuadrove të MFSK-së, përmes programeve të studimeve Baçeler dhe Master. Drejtimet në të cilat mund të përfitojnë më së shumti pjesëtarët e MFSK-së, janë: Ekonomi Biznesi-Tregti e Jashtme, Politikë Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Juridik, Marrëdhënie Juridike Ndërkombëtare, Menaxhment, Banka-Financa dhe Kontabilitet, Psikologji, Sociologji, Shkenca Politike dhe Administratë Publike, Kriminalistikë, Juridik-Civil, Juridik-Penal, Emergjencë, Shkenca të Sigurisë, e të tjera.

Memorandumi i bashkëpunimit hynë në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

UBT-ja në vazhdimësi përfiton projekte nga TEMPUS-i

Forum për "Ditët e cilësisë në UBT"

Presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi, pasi ka përshëndetur të pranishmit në forum, ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen që po ia jep Universitetit të cilin ai e drejton

Prishtinë, 15 tetor - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), të premtën ka organizuar forumin me temën "Ditët e cilësisë në UBT".

Me theks të veçantë në këtë forum është prezantuar projekti "Mbështetja dhe zhvillimi i cilësisë në institucione private të arsimit të lartë në Kosovë", përfitues i të cilit është Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) falë cilësisë së tij tashmë të dëshmuar.

Presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi, pasi ka përshëndetur të pranishmit në forum, ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen që po ia jep Universitetit të cilin ai e drejton.

Objektivi kryesor i projektit është që UBT-ja në

vazhdimësi ta rris sistemin e Sigurisë së Cilësisë.

Projekti është iniciuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës

dhe Teknologjisë (MASHT) dhe WUS Austria, e përkrahur



nga TEMPUS-i, gjegjësisht nga Komisioni Evropian. Po ashtu partnerë ndërkombëtarë në këtë projekt janë edhe University College Cork, University of Salzburg dhe University Politehnica of Bucharest.

Përveç të parit të UBT-së, z. Hajrizi, në këtë forum kanë marrë pjesë, presidenti i Universitetin edhe stafi menaxhues si dhe studentët e të gjitha fakulteteve, palët partnere të projektit si: Mr. Bud Dedaj, drejtor ekzekutiv i WUS-Austria në Kosovë, Prof. Dr. Ferdije Zhushi, kryetare e Këshillit Kombëtar të Cilësisë, Basri Muja, drejtor i Agjencionit për Akreditim në Kosovë.

Në forum secili zyrtar ka prezantuar institucionin të cilin e përfaqësonte.

Krasniqi zgjidhet Kryetar i Organizatës Studentore të UBT-së

**Prishtinë,
03 dhjetor 2010 -**

Në vazhden e mbledhjeve të shumta, për zgjedhjen e Kryetarit dhe kryesisë së ngushtë, sot në objektin e UBT-së, Organizata Studentore e UBT-së, zgjodhi strukturën e re dhe të parin e kësaj organizate.

Në garë për postin e Kryetarit të organizatës në fjalë ishin: Saranda Musliu, Filiz Salihu, Agron Krasniqi dhe Kreshnik Ismaili.

Pas votimit nga 17 anëtarë, kryetari i komisionit zgjedhor Durim Dabiqi dhe dy anëtarët: Delfina Jusufi dhe Pajtim Thaqi, para të pranishmëve në sallë numëruan votat ku Kryetar i "Organizatës Studentore të UBT-së" u zgjodh Agron Krasniqi, student i vitit të II-të në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.

Nënkryetare u zgjodh Saranda Musliu. Kreshnik Ismaili u zgjodh kryetar për sektorin e Sportit dhe të Rekreacionit, kurse Filiz Salihu, kryetare për sektorin e Kulturës dhe aktivitete sociale. Anëtar i komisionit për sektorin e Sportit u emërua Fidan Bujupi, kurse Lirigzona Morina, anëtare në sektorin e Kulturës.



Programi njëvjeçar i Kryetarit A. Krasniqi
Misioni është si vijon:

Bashkëpunimi me studentë dhe staf për çështje të cilësisë së ligjërimit, respektimin e rreg-

ullores së UBT-së, organizimi i çështjeve sportive, organizimi i ekskursioneve të ndryshme, organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sociale.

Objektivat janë këto:

Matja dhe kontrolli i cilësisë së studentëve dhe profesorëve, respektimi i rregulloreve të UBT-së, shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të studentëve, mbajtja e turneve të disiplinave të ndryshme si: Futboll, Basketboll, Paintboll dhe disiplinave tjera sipas kërkesave të studentëve, bashkëpunime dhe gara me universitete tjera, organizime të kuizeve të diturisë brenda UBT-së, ekskursione jashtë vendit, Itali dhe Austri, pjesëmarrje dhe organizime me aktivitete të ndryshme në festa dhe vizita në fabrika dhe ndërmarrje të ndryshme në Kosovë.

Biografia e kryetarit të Organizatës Studentore të UBT-së

- Agron Krasniqi u lind më 09.10.1988 në Prishtinë, dhe jeton në Fushë-Kosovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, dhe të mesmen në Gjimnazin e përgjithshëm "Hivzi Sulejmani", në Fushë-Kosovë. Ka ndjekur një mori

kurseve për gjuhët të huaja si atë angleze dhe gjermane në "Cambridge, Oxford & Zastava Trade" në Prishtinë, dhe kurse për "Cisco System and Networking" (AUK). Në vitin 2009 fillon studimet në "Universitetin për Biznes dhe Teknologji" (UBT), Prishtinë, ku për momentin është student i vitit të dytë. Po ashtu, Agron ka një mori certifikimesh si: IT ESSENTIALS, CCNA DISCOVERY 1, CCNA DISCOVERY 2, CCNA DISCOVERY 3, CCNA DISCOVERY 4.

Merret me aktivitete dhe organizime të shumta. Që nga viti 2004 është anëtar i "Kryqit Kuq". Gjatë vitit 2005-2007 anëtar i "Global Motion", nga 2006 vazhdon të jetë anëtar i "Forumi rinor, Fushë-Kosovë". Në vitin 2010 bëhet anëtar i "FLYING FOR KOSOVO".

2009-2010 administrator i websajtit "www.lajmefutboll.com", më pas mirëmbajtës i Fan Page (James Berisha - FFK), po ashtu themelues dhe mirëmbajtës UBT-FACEBOOK, organizator i mbrëmjes shoqërore të studentëve të UBT-së, dhe në fund organizator i vizitës "Albania Trip", për 28 nëntorin 2010.

Studentët e UBT-së organizuan party

**Prishtinë,
8 nëntor 2010 -**

Studentët e vitit të parë dhe të vitit të dytë të të gjitha fakulteteve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), organizuan një ndejë në shenjë të shënimit të fillimit të vitit të ri akademik 2010/2011.

Në ndejën e organizuar në lokalin "P1 CLUB", në Prishtinë, përveç një numri të madh studentësh, morën pjesë edhe profesorë dhe mysafirë të tjerë.

Ndejja u shoqërua me muzikë nga "dj. Flow", që krijoi një atmosferë të mirë të shoqërimit dhe festimit të nisjes së jetës akademike për studentët e rinj.

Menaxhemti i lartë i UBT-së ka premtuar se në bashkëpunim me studentët do të organizojnë takime të tilla më të shpeshta.



Astritin e kam profesor dhe punëdhënës

"Presidentit i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka bërë punë të mrekullueshme që ka themeluar UBT-në, dhe po implementon standarde të larta në këtë universitet. Niveli i studentëve nga UBT, që kanë ardhur në "Rrotë" për punësim ose punë praktike ka qenë jashtëzakonisht i kënaqshëm. Padyshim mund të them që "Rrota" ia ka pa hajrin punës së mirë e cila bëhet në UBT", tha lideri i kompanisë "Rrota", njëherit edhe mësimdhënës në UBT, Prof. Astrit Hyseni, për gazetën "UBT News".

**Armend Morina
dhe Afrim Baliqi,
STUDENTË NË UBT**

Studentët e UBT-së, përveç që ndjekin procesin mësimor ata kanë edhe bashkëpunim të mirë me mësimdhënësit e tyre. Bashkëpunimin më të freskët e gjejmë në punësim si në kompani private ashtu edhe ato publike. Në këtë rast si shembull kemi marr studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, të cilët disa nga ta sot vetëm i gjejnë të punësuar në kompanitë më profitabile në vend siç është kompania "Rrota", ku lideri i kësaj kompanie, për studentët e UBT është edhe punëdhënës edhe profesor.

Rrota ja ka pa hajrin UBT-së

Ky bashkëpunim i ndërsjellët studentë - profesor vjen si rezultat i punës së tyre të pandalshme gjatë tërë vitit akademik, dhe profesori Astrit, duke parë angazhimet, suksesin dhe aftësitë e studentëve, në të njëjtën kohë i punëson në kompaninë që ai drejton, një kompani kjo e rangut më të lartë në vend siç është "Rrota".

"Presidentit i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka bërë punë të mrekullueshme që ka themeluar UBT-në dhe po implementon standarde të larta në këtë universitet. Niveli i studentëve nga UBT që kanë ardhur në "Rrotë" për punësim ka qenë jashtëzakonisht i kënaqshëm. Padyshim mund të them që "Rrota" ua ka pa hajrin punës së mirë e cila bëhet në UBT", tha lideri i kompanisë "Rrota", njëherit edhe mësimdhënës në UBT, Prof. Astrit Hyseni, për gazetën "UBT News".

Ai shprehet se kombinimi i studimit akademik në UBT dhe punës praktike në projekte konkrete industriale të cilat i bëjnë në "Rrota" është përfitues për këta student. Hyseni shprehet se ka përshtypjen që studentët e UBT-së e kanë një situatë të favorshme në kuadër të



studimeve të tyre akademike dhe përfitimit të përvojës së tyre të punës.

Ai me tej cekë shumë aspekte të cilat UBT-në e veçojnë në treg, por ajo që e bënë më të dallueshme është niveli i lartë i shkencave kompjuterike dhe kualiteti i lartë i stafit akademik të involvuar në mësimdhënie.

E konsideroj veten me fat që jam pjesë e Rrotës

"Jam shumë e kënaqur për angazhimin dhe ndihmën që mund t'ia jap kompanisë "Rrota", se kjo kompani më ka mbështetur dhe përkrahur gjatë gjithë përvojës time, nga dita e parë e punës e deri më sot, dhe e konsideroj veten me fat që jam pjesë e një shtëpie të madhe e të suksesshme", tha Gëzime Idrizi, studente në UBT, dhe njëkohësisht e punësuar që dy vite në këtë kompani në fjalë. Ajo më tej shprehte se besimi dhe përgjegjësit në punë, hapësira për të menaxhuar për

pozitën që mban, që i është ofruar nga kjo kompani, sipas saj gjetiu do të duhej të kalonte një kohë e gjatë për ti fituar këto privilegje.

Qëndresa Hajdari po ashtu studente në Fakultetin Shkencave Kompjuterike në UBT dhe punëtore brenda kompanisë "Rrota" shprehet se kah fundi i përfundimit të ligjëratave të vitit të III-të ka filluar praktikën në "Rrotë", dhe pas një kohe kalon si staf i rregullt, ku asaj i besohet puna si programere." Në ligjëratat e profesori Astriti kam qenë aktive tërë kohën, dhe me përfundimin e tyre profesori më ofroi punësim në "Rrotë", thotë ajo.

Po ashtu fatin e Qëndresës për punësim e kanë pasur edhe studentët tjerë si Faton Selishta, Bleron Zherka, Durim Jusaj dhe Petrit Bytyqi të cilët janë pikërisht studentët të Prof. A. Hysenit, dhe në të njëjtën kohë janë të punësuar edhe në kompaninë "Rrota", të cilët shprehen se njo-

huritë e marruar në ligjëratat pikërisht të profesori i tyre dhe ato i zbatojnë në punë.

"Rrota" kompani më e respektuar në vend dhe në rajon

Kompani "Rrota" në Kosovë po edhe në rajon është njëra ndër kompanitë më të respektuara në fushën e punimit të ueb faqeve, ndërsa mes tjerash ofron edhe shërbime të zhvillimit të ueb aplikacioneve, fushatave të marketingut dhe vetëdijesimit si dhe të dizajnit grafik.

"Rrota" gjatë vitit 2011 i bën konkurrencë tregut të perimeve


Menaxhmenti i lartë i kompanisë në fjalë, gjatë bisedës që patëm për realizimin e temës për gazetën "UBT News", thonë se për vitin 2011 kanë risi të shumta, por, për mos ta lodhur lexuesin e gazetës në fjalë veçojnë vetëm sektorin e perimeve. "Prej vitit 2011 kemi vendosur të

zgjerojmë veprimtarinë tonë me kultivimin e specave duke pas parasysh efektin e tyre pozitiv në një ambient të ndotur sikurse është kryeqendra jonë Prishtina. Jam i bindur që një sintezë e mirëfilltë e mëtutjeshme mes komunikimit, teknologjisë informative dhe specave do të na mundësojë edhe me tutje të dallohemi në treg për shërbimet tona", tha Profesori Astrit.

Filloj me tre punëtorë kurse sot ka mbi 30

"Rrota" është shtëpi prodhuese Multimediale e cila merret me shërbime të komunikimit dhe të teknologjisë informative, e cila është themeluar në vitin 2002 nga Shkumbin Brestovci. Si veprimtari fillestare e ka pas botimin e stripave (fillimisht Alan Fordin, Spider Man, X Man). Punën e saj e ka filluar me tre anëtar, ndërsa sot numëron mbi 30 bashkëpunëtorë. Përveç që ka projekte në Kosovë, momentalisht ofron edhe shërbime të outsourcing për kompani jashtë Kosovës, sidomos në shtetet e Bashkimit Evropian, me fokus të veçantë në Austri dhe Suedi. Rrota gjithashtu ka disa projekte në Shqipëri (me e ProCredit Bank e Shqipërisë), ku perspektiva e zhvillimit të biznesit gjithashtu janë premtuese.

Që nga fillimi filozofia e "Rrotës" ka promovuar vlera të mirëfillta si në standarde të rezultateve të punës ndaj klientëve, ashtu edhe ndaj bashkëpunëtorëve të saj. Koncepti i CSR (Corporate Social Responsibility) është i rëndësishëm për "Rrotën", dhe ky manifestohet sidomos në sponsorime të shumta të projekteve kulturore si dhe atyre profesionale. "Rrota" ka mbështetur të fuqishëm edhe FLOSSK-un në organizimin e dy konferencave të deritanishme për Softuer të Lire dhe të Hapur që janë mbajtur në Kosovë ku kanë treguar efekt jashtëzakonisht pozitivë në komunitetin vendor të teknologjisë informative.



UBT ME KAMPUS TË RI UNIVERSITAR

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), brenda vitit të akademik 2010/2011, procesin mësimor pret ta organizojë në kampusin e ri universitar. Kampusi i ri është në afërsi të QMI-së, në Komunën e Lipjanit.

Projekti i kampusit është projektuar nga studentët e diplomuar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT si Ardian Muhadri, Fidan Belegu etj, dhe stafi akademik ndërkombëtar e vendor.



Presidenti i UBT-së, E. Hajrizi mori pjesë në takimin vjetor dhe në Kongresin Botëror të IPMA-së, në Stamboll të Turqisë

Dr. Hajrizi, asesori i parë në trevat shqip-folëse i akredituar nga IPMA

Prishtinë, 6 dhjetor 2010 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në mbledhjen vjetore të Këshillit të Përgjithshëm dhe në Kongresin Botëror të Programit Ndërkombëtar për Menaxhim të Projekteve (IPMA), të zhvilluar në Stamboll të Turqisë.

Në këtë takim Dr. Hajrizi ka paraqitur një pasqyrë të plotë të projekteve të zhvilluara në UBT si dhe ka bërë një rekapitullim të gjerë të zhvillimeve në Republikën e Kosovës, në kupti-



min e krijimit të legjislacionit dhe hapjes rrugë të iniciativave të reja në fushën e menaxhimit të projekteve, një fushë relativisht e re në vendin tonë.

Po ashtu, në këtë takim përveç të tjerave si rend dite zyrtarisht para të pranishmëve Kryetari i Komitetit Ndërkombëtar, Y Hans Knoepfel ia dorëzoi vendimin e IPMA-së z. Edmond Hajrizit dhe e shpalli si asesori (vlerësuesi) i parë i akredituar nga IPMA në Kosovë dhe në gjithë trevat shqip-folëse për menaxhimin e projekteve.

IPMA është organizatë me nivel botëror në fushën e Menaxhimit të Projekteve, e cila certifikon menaxherët e projek-

teve, krijojnë ekupe për menaxhimin e projekteve dhe hulumtues të suksesshëm, si dhe nxjerrë publikime të ndryshme lidhur me menaxhimin e projekteve.

UBT është anëtar me të drejta të plotë në IPMA, i anëtarësuar me votat e shumicës së vendeve anëtare.

Në vitin 2009 kjo mbledhje u mbajt në Dublin të Irlandës, ku përfaqësuesit e Serbisë e patën kundërshtuar anëtarësimin e Republikës së Kosovës përmes

UBT-së në këtë institucion, si dhe kanë protestuar ndaj pjesëmarrjes së dr. Hajrizit në konferencë. Por, kjo situatë është tejkaluar pas reagimit të shumicës së anëtarëve të IPMA-së dhe të z. Hajrizit, i cili shpjegoi se Republika e Kosovës është shtet i pavarur dhe i anëtarësuar në shumë institucione ndërkombëtare, në shumë prej të cilave është pikërisht UBT që ka siguruar anëtarësimin dhe përfaqësimin e shtetit më të ri në botë.

Identifikimi i humbjeve komerciale në Sistemin Energjetik të Kosovës

Mimoza Dugolli

Reduktimi i humbjeve në përgjithësi është një prej sfidave më të mëdha dhe objektive kryesore të çdo menaxhmenti, jo vetëm në Kosovë por në çdo kompani energjetike kudo në botë. Studime dhe analiza të ndryshme kanë treguar se për shkak të humbjeve e posaçërisht atyre komerciale, shkaktohen humbje të bilionave në kompanitë energjetike nëpër gjithë botën.

Në aspektin gjeneral, në sistemin energjetik ekzistojnë dy lloje të humbjeve. Ato mund të jenë teknike dhe komerciale. Përderisa humbjet teknike janë të shkaktuara nga faktorët teknik, humbjet komerciale shkaktohen kryekëput nga faktori njeri.

Sektori energjetik në Kosovë është i dominuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila momentalisht është i vetmi prodhues i energjisë elektrike. Kjo korporatë përbëhet nga katër divizione kryesore: Divizionin e Mijëve, Gjenerimit, Rrjetit dhe Furnizimit. Momentalisht furnizon me energji 400 mijë konsumatorë dhe shtrihet në tërë territorin e Kosovës.

Sfidat kryesore me të cilat momentalisht ballafaqohet kjo korporatë janë: Problemet në lidhje me gjenerimin e mjaftueshëm për përmbushjen e kërkesës për energji. Dy transaksione privatizimi të pezulluara: Transaksioni Mijë- Gjenerim dhe Transaksioni Rrjet-Furnizim. Humbjet në përqindje të lartë, dhe tarifart artificialisht të ulëta, që pamundësojnë mbulimin e



shpenzimeve kapitale.

Humbjet komerciale në veçanti për Korporatën Energjetike të Kosovës, sidomos pas periudhës së luftës kanë qenë problematika kryesore me të cilën është ballafaquar menaxhmenti i kësaj korporate. Në periudhën e pas luftës, Korporata Energjetike u menaxhua edhe nga kompani të specializuara ndërkombëtare me qëllim për ta stabilizuar atë dhe shndërruar në një korporatë financiarisht të qëndrueshme, por përkundrazi ata vetëm sa e thelluan krizën brenda kësaj korporate. Vetëm që nga viti 2006 kompania fillon të tregojë rezultate pozitive në aspektin e zvogëlimit të përqindjes së humbjeve komerciale si rezultat i për-

mirësimit të menaxhimit dhe atë nga vendorët. Megjithatë, duhet marrë parasysh faktin që për të qenë efikasiteti më i lartë dhe për të zvogëluar humbjet në tërësi, ekzistojnë shumë hallka të këtij procesi, për të cilin janë përgjegjës edhe faktorë tjerë po aq të rëndësishëm sa edhe vet menaxhimi i suksesshëm.

Faktorët që ndikojnë dhe shkaktojnë këto humbje, në vende të ndryshme mund të jenë të ndryshme. Këtu tek ne, në Kosovë këta faktorë janë: Lidhja ilegale në rrjetin shpërndarës të energjisë, respektivisht vjedhja e energjisë elektrike, Mosfunksionimi i sistemit të gjyqësorit, posaçërisht sa i përket rasteve të vjedhje të energjisë,

Çështjet socioekonomike, Enklavat, Transformimi i brendshëm i kulturës së Korporatës Energjetike të Kosovës.

Për Korporatën Energjetike të Kosovës, e ardhmja do të jetë e drejtuar kah shumë objektiva. Përveç që duhet të rregullohet në aspektin e gjenerimit të mjaftueshëm të energjisë, luftimit të humbjeve, ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të reja, etj. ajo do të duhet të trajtojë edhe çështje tjera po aq të rëndësishme, në aspektin e globalizimit dhe përmbushja e objektivave të EU, për prodhimin e energjisë së pastër.

Në toplistë do të jetë përmirësimi i kualitetit të shërbimit, përderisa realizon rritjen e efika-

sitetit operacional, integrimi i energjisë së ripërtërishme dhe eficientia e energjisë.

Smart grid është përgjigja e këtyre sfidave dhe Smart metter është hapi drejt kësaj.

Kjo ese është përmbledhje e punimit shkencor që autorja ka prezantuar në "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010.

Autorja është alumni i UBT-së, dhe aktualisht mban pozitën Menaxhere e Departamentit të Përkrahjes Afariste, në Divizionin e Furnizimit në Korporatën Energjetike të Kosovës, KEK.

Presidenti i UBT-së, z. Hajrizi mori pjesë në takimin dhe në kongresin e EOQ, të mbajtur në Republikën e Turqisë

UBT-ja e themeloi organizatën QK dhe e anëtarësoi në EOQ

7 dhjetor 2010, Prishtinë- Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë fundmuajit nëntor dhe fillim-dhjetorit ka qëndruar për disa ditë më radhë në Republikën e Turqisë, dhe ka zhvilluar një varg takimesh me disa drejtues të Universiteteve për bashkëpunim ndëruniversitar. Si pjesë e agjendës së rëndë-

sishme të z. Hajrizit, ishte edhe pjesëmarrja në takimin e radhës së Organizatës Ndërkombëtare për Cilësi (EOQ), dhe më pastaj pjesëmarrja e tij në Kongresin Evropian të Organizatës Ndërkombëtare për Cilësi (EOQ), të zhvilluar pikërisht në Izmir të Turqisë.

Në këtë takim Dr. Hajrizi ka paraqitur një pasqyrë të plotë

të projekteve të zhvilluara në UBT si dhe ka bërë një rekapitullim të gjerë të zhvillimeve në Republikën e Kosovës. Më pas, ai foli më detajisht edhe për Organizatën Quality Kosova (QK).

"Duke e parë rendësinë e cilësisë dhe të standardeve në Kosovë, ne si institucion universitar kemi munduar dhe kemi

marrë iniciativën dhe kemi themeluar organizatën Quality Kosova (QK). Përmes kësaj organizate sot Kosova është anëtare në Organizatën Evropiane për Cilësi (EOQ)", tha Presidenti i UBT-së, Prof. dr. Edmond Hajrizi, në kongresin Evropian për Cilësi të organizuar në Izmir të Turqisë.

Të gjitha vendet e zhvilluara

kanë organizata të tilla, të cilat mundohen ta promovojnë cilësinë e vendit të vet, dhe me themelimin e organizatës në fjalë, edhe Kosova sot është karshi tyre", vazhdoi Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, pas përmbylljes së Kongresit në Izmir të Turqisë.

A e ka formësuar globalizimi kursin e marrëdhënieve ndërkombëtare?

Valon Murtezaj

Globalizimi e ka formësuar botën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në shumë mënyra, dhe mund të themi me pak hezitim se nuk jetojmë më, dhe as punojmë në shtete unike sovraane. Ekonomitë dhe shoqëria kanë dhe vazhdojnë të evoluojnë shpejt, dhe globalizimi është trendi që vazhdon t'i riformësoj kufijtë e bashkëveprimeve tona individuale dhe kolektive.

Megjithatë, përshkrimi i ndikimit të globalizimit nëpër botë, në njerëzit, në ekonomitë dhe kulturat ende bëhet nga shkolla të ndryshme të mendimit. Një këndvështrim thotë se globalizimi është diçka që ka ndihmuar botën të bëhet më e vogël dhe ku njerëzit, kombet dhe kulturat janë afruar. Sipas përkrahësve të globalizimit të gjitha të mirat që kemi sot, nuk do të ishin të mundshme pa globalizimin, dhe pra është globalizimi procesi që i ka bërë këto procese më të lehta, më pak të kushtueshme për ekonominë në përgjithësi.

Të tjerët besojnë që globalizimi ka kontribuar drejt ndarjes së popujve duke krijuar dallime të mëdha ndërmjet kombeve dhe duke zgjeruar edhe më tej hendekun ndërmjet të pasurve dhe të varfërve. Më tej në të dy anët, në ekonomitë e zhvilluara dhe të pazhvilluara, ka pikëpamje skeptike për globalizimin dhe të cilat përshkohen me doza frike.

Për cilindo vend apo organizatë sot është qenësore të



adaptohet në ndryshimet e epokës së globalizimit. Në mënyrë të qëndrohet mirë, organizatat dhe vendet duhet të përgjigjen në mënyrë strategjike konkurrencës, dhe në tërë këtë komunikimi elektronik modern ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm. Në një treg të globalizuar shumë të konkurrueshëm, përditësimi i teknologjisë del të jetë një element që donë vëmendje konstante. Në këtë kontekst, shikuar nga një dimension tjetër, atë të të drejtave të

njeriut, informacioni mund të përdoret dhe keqpërdoret, dhe kjo është një aspekt i rëndësishëm të konsiderohet në epokën e botës plotë teknologji.

Tregjet globale ofrojnë mundësi më të mëdha për vendet dhe kompanitë për të qenë pjesë e tregjeve të mëdha. Përkundër dallimeve në zhvillim që ekzistojnë ndërmjet vendeve, çdo shtet duhet të bëjë përpjekje të zvogëlojnë varfërinë, dhe asnjë vend nuk duhet të mbetet i izoluar nga procesi i

globalizimit. Pabarazia është një element që duhet të adresohet në mënyrë adekuate, dhe kjo është përgjegjësi e secilës qeveri apo trup ndërkombëtar.

Ekonomitë e avancuara mund të kontribuojnë për të ndihmuar vendet në zhvillim dhe ato që jetojnë në varfëri, duke ju lehtësuar rrugëtimin e tyre në integrimin në ekonominë globale. Kjo duhet të bëhet duke ju ofruar atyre qasje të pakufizuar në treg për të gjitha eksportet, dhe duke inkurajuar rrjedhën e kapitalit

privat në investime direkt në këto vende. Kjo do ta bënte, pastaj, botën një vend më të sigurt dhe më të mirë për të jetuar në të.

Autori është alumni i UBT-së, dhe aktualisht është profesor në UBT dhe në Francë. Kjo ese është përmbledhje e punimit shkencor që autori ka prezantuar në "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010.

Etika profesionale

Nora Hasani

MBE, VITI II-TË

Etika përfshin jetesën sipas normave dhe rregullave të shoqërisë. Etika e biznesit shpreh bashkësinë e standardeve të sjelljes morale dhe profesionale në përkushtim të detyrës dhe të detyrimeve që punonjësit e një firme kanë në komunikimin me njëri-tjetrin, me eprorët, me personelin e jashtë firmës, me klientët, përgjithësisht me mjedisin natyror, shoqëror dhe publik. Apo ajo mund të jetë edhe shprehje e marrëdhënieve në biznes, p.sh. në marrëdhëniet si i punësuar dhe punëdhënës, si aksionar ose pronar dhe menaxher e nëpunës, si blerës e shitës, si huadhenës.

Kodin e mirësjelljes profesionale e ka zhvilluar fillimisht Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), gjatë viteve '20 të shekullit të kaluar.

Në çdo rast etika përcaktohet si faktor që ndikon në maksimizimin e profitit të një subjekti biznesi, si dhe në krijimin e një mjedisi për realizimin në mënyrë të qëndrueshme të këtij objekti.

Çdo firmë zgjedh dhe vendos të ndjekë një paketë



rregullash, që kanë të bëjnë me standardet e sjelljes së punonjësve të saj, me

mënyrën e veshjes, të komunikimit etj., që formojnë kodin etikë të firmës të fir-

mës në fjalë.

Në biznes, këto forma dhe rregulla identifikojnë sjelljen e përshtatshme për menaxherët, të punësuarit dhe aksionarët e tjerë. Informimi i plotë investuesve dhe i aksionarëve të tjerë për menaxherët.

Menaxherët që i maskojnë veprimtaritë e tyre ose nuk i paraqesin mirë këto veprimtari, e bëjnë të vështirë për aksionarët që të vlerësojnë ecurinë e një biznesi. Mbivlerësimi i fitimeve, për shembull, mund t'i bëjë investuesi që t'i shpërndajë më shumë burime një kompanie se sa mund të justifikohet nga rezultatet e tanishme. Kjo keqshpërndarje rezulton në humbjen e vlerës për shoqërinë dhe shpesh çon dëmtimin financiar për ata që e përdorin këtë informacion. Nuk është njësoj për menaxherin e firmës që me rastin e kontraktimit të punëtorëve të paraqes informata të pabesueshme, të cilat më vonë do të krijojnë situata jo të mira për të dhe biznesin që ai menaxhon. Në raste të tilla humb firma, por humb edhe reputacioni i menaxherit, sepse raporton edhe kontrollon informatat e kontabilitetit.

-Ne objektivitetin e inform-

ative të përgatitura, të raportuara dhe të kontrolluara.

-Në pavarësinë profesionale të personit që përgatit ai del si menaxher i pabesueshëm.

Sjellja etike është veçanërisht e rëndësishme për kontabilistin, pasi besueshmëria e informacionit kontabël varet nga ndjeshmërinë e atyre që përgatisin, raportojnë dhe kontrollojnë këtë informacion. Zakonisht personat që merren me këto çështje, duhet të bazohen rreptësisht në kodin e mirësjelljes profesionale, i cili kod duhet bazuar në tri parime themelore: Në integritetin e personit që përgatit, raporton ose kontrollon informatat, në objektivitetin e informatave të përgatitura, të raportuara dhe të kontrolluara dhe në pavarësinë profesionale të personit që përgatit, raporton ose kontrollon informatat.

Të bazuarit në këto tri parime themelore, mundëson që të mënjanohej gabimet e vogla etike dhe të fokusohemi në reputacionin tonë afatgjatë, qoftë si menaxherë ose kontabilistë, të përgatitemi për të pritur dhe të përjetojmë konsekuenca personale për mbajtjen e pozicionit etik.

Studentët e UBT-së vizituan Shqipërinë

Fidan Bujupi

STUDENTË NË UBT,
MEKATRONIK, VITI II

fotografitë si dhe përmendoret e të gjithë atyre që kontribuan për vendin në ngritjen e flamurit.

Diskoteka "Lollipop", organizoi ndejë deri në orët e vona të mesnatës për studentët nga

Kosova.

Mikpritës i studentëve të UBT-së ishte edhe pronari i "Hotel

Grandin", ku studentëve për tre ditë më radhë u ofroi shërbim komod.

Shqipëri, 27 nëntor 2010 -

Studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), për nder të Festës Kombëtare "28 Nëntori", ditës së Flamurit Shqiptar, organizuan vizitë tre ditore në Shqipëri. Qyteti i parë që u vizitua nga studentët dhe menaxhmenti i UBT-së ishte Tirana. Vizituan kryeqendrën, nuk e lanë anash as Panairin e pemëtarisë, ku ishin të ekspozuara shumë produkte vendore të vendit shqiptar. Studentët nuk hezituan të hynin në bashkëbisedim me shitësit e produkteve dhe u njoftuan më hollësisht se çka dhe çfarë produkte ofron Shqipëria. Pas kësaj vizite edhe Pallatin e Kongreseve.

Ditën e dytë të vizitës, studentët e UBT-së i gjejmë në qytetin historik Vlorë, qytetin ku me 28 Nëntor 1912 u ngrit Flamuri kombëtar shqiptar nga Ismail Qemali. Më pas vizituan edhe Muzeun e qytetit historik, ku për së afërmi patën rastin t'i shohin mbishkrimet e ndryshme,



UBT organizoi workshop me temën

Programi për Menaxhimin e zonave ekonomike në Kosovë

Prishtinë, 22 dhjetor 2010 -

Në ambientin e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), është organizuar punëtori-workshop me temën "Programi për menaxhimin e zonave ekonomike", si vazhdimësi e projektit të iniciuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), respektivisht nga Agjencia për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (AMNVM) dhe të implementuar dhe koordinuar UBT-ja.

Me këtë rast, në workshop u prezantuan eksperiencat rajonale dhe ndërkombëtare të menaxhimit të zonave ekonomike dhe gjithashtu janë prezantuar eksperiencat e marra nga vizita studimore që është bërë javën e kaluar në Republikën e Sllovenisë.

"Qëllimi i vizitës ishte që të merren praktikë e mira rreth menaxhimit të zonave ekonomike pasiqë, nga përvojat dhe nga praktikë e mira mund të krijojmë një vizion më të qartë rreth asaj se si në të vërtetë mund të menaxhohen më mirë zonat ekonomike, dmth, cili model do të ishte më i miri për rastin e Kosovës", tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi. Më tej i pari i UBT-së, Dr. Hajrizi, rëndësi në debat i dha anëve pozitive nga vizitat në fjalë, si për aspektet ligjore, aspektet menaxheriale –organizative, ato financiare etj.

Po ashtu Kryeshefi i AMNVM, Naser Graiqevci, foli për rolin e Agjencisë për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, duke marrë shembullin e Parkut të Biznesit në Drenas. Më pas foli për modelet e marruara



nga shtete e ndryshme dhe mundësinë e përshtatjes në vendin tonë.

Grupi punues i përbërë nga palët e interesit për menaxhimin e zonave ekonomike kanë debatuar rreth krijimit të

një kompanie model për menaxhimin e zonave ekonomike në Kosovë.

Te ftuarit për debat në këtë grup punues në workshop ishin nga institucionet si: MTI, ZKM, MEF, MTI-AMNVM,

MTI-APIK, MALP, Asociacioni i Komunave, Qendrat e zhvillimit rajonal (5 qendrat), OEK, OEA, AKB dhe Banka Botërore.

Workshopi rezultoi të ketë pasur debat të frytshëm dhe

prezantim të projektit, ndërsa në takimet tjera në vazhdimësi grupi punues do të ketë për obligim krijimin e kompanisë modelin dhe biznesplanin për menaxhimin e zonave ekonomike.

UBT trajnon kandidatë për mekatronikë

Prishtinë, 20 dhjetor 2010 -

Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), u organizua trajnimi për sektorin e mekatronikës. Në këtë trajnim morën pjesë të gjithë ata persona që kanë të implementuar sistemin e mekatronikës nëpër institucionet të cilat ata i menaxhojnë si në industri, prodhimtari, servisim.

Arsyeja e mbajtjes së këtij trajnimi në UBT ka të bëjë me infrastrukturën dhe stafin profesional më përvojë në fushën të cilën janë trajnuar. Stafin trajnues i për-

berë nga Dr. Bekim Gashi, Dr. Bertan Karahoda dhe Sherif Hyesin, alumni i UBT-së.

Trajnimi ka zgjatur një javë dhe ka përfshirë anën teorike dhe praktike, ndër të tjera ka përfshirë edhe proceset në dizajnin e sistemeve mekatronike dhe duke e marrë parasysh dizajnimin e sistemeve mekanike, elektronike, dhe sistemet e duhura kompjuterike për implementimin e sistemeve mekatronike.

Të trajnuarit vinin nga kompanitë private dhe institu-



Viti 2020

Enver Kurteshi

STUDENT NË MBE VITI I

Jemi në vitin 2020, besoni ose jo Hashim Thaçi është ende kryeministër, nuk ka ndryshuar thuajse asgjë përveç që është thijnur dhe ka mësuar edhe ca fjalë më shumë anglisht. Këta dy muajt e fundit si ngjarje kryesore dhe teme ditore e televizionit shtetëror "HashaTV" është fshati Mramur. Në Mramur po ndërtohet një lagje e re e cila pritet të jetë HighTech (teknologji e lartë). Por për shkak të këtij projekti madhështorë janë në luftë dy partitë politike dhe teknologjike të vendit PTDK (Posta dhe Telekom) Demokratik i Kosovës dhe HashiPko.

Banorët e kësaj lagjeje do të kenë një jetë më të ndryshme nga ajo të cilën e kemi jetuar deritani. Ndryshimi më i madh në këtë lagje është mënyra e



votimit, ku çdo shtëpi do të jetë e paisur me kutinë elektronike të votimi, ku brenda çdo kohe mund ta japësh apo ndryshosh votën tënde. Pra me këtë "Pilot-project" (projekt testues) mundësohet votimi

dhe numërimi interaktiv i votave. E gjitha kjo ka ardh si rezultat i incidentit të vitit 2010 kur Presidenti Fatmir Sejdiu shkeli ca rregulla dhe e larguan nga puna, por pas largimit të tij, mbetëm pa President apo

siç populli thoshte atëherë "kena met pa zot shpie" edhe pse këto ndryshime nuk u vunë re nga qytetaret e thjeshtë, por nga prapavija politike Kosova vuajti shume nga ky kaos. Kjo mundësi e re votimi në rast përsëritje të incidentit të vitit 2010 apo ndonjë incident tjetër të ngjashëm politik do të na mundësojë zgjidhjen e qeverise, presidentit apo krize brenda pak orëve.

Mramuri përveç kutsisë digjitale të votimit ka në plan edhe një park të madh për rekreacion, i cili do të shërbejë çdo banori ta kalojë kohën aty. Gjëja më e avancuar në këto park do të jetë Bari Sintetik Interaktiv, zbulimi i fundit nga bota bimore. Ky lloj bari është i menduar të përshtatet çdo sporti, moti, ere, të mbron kur rrëzohesh, të përkëdhel kur shtrihesh, të qetëson kur nervozohesh etj. Por sipas disa thashethemeve i tërë ky projekt

për të mire të qytetarit do të shkojë huç, përshkak se në vend të tij do ta bëjnë një vendparkim me pagesë.

Banori i parë i kësaj lagjeje do të jetë Albin Kurti. Shteti ia dha këtë nder Albinut si dëmtsh-përblim i dënimit të me 10 vite burg. Albin u lirua nga burgu para tre muajve pasi që gjykata botërore vendosi se nuk ka asnjë fakt që ai të vuaj atë denim të pabaze. Albin tani gjendet në rehabilitim, sepse pas torturave dhe krizave psikike që kishte gjatë qëndrimit në burg, ai tani mendon se është Che Guevara, mjekët e tij thonë se flet vetëm gjuhën kubano-spanjolle.

Shpresojmë se Albin do të përmirësohet dhe të jetë në gjendje ta shijoj banim në këtë lagje modern, shpresojmë edhe se kjo lagje të përfundojë sa më shpejt dhe ta shijojmë të gjithë nga pak këtë bukuri teknologjike.

UBT certifikon edhe 23 kandidatë për ciceron

"Pas një pune të suksesshme, po e mbyllim një trajnim që për herë të dytë mbahet në Kosovë, pikërisht në UBT, trajnimi për ciceronët turistik. Ne si UBT kemi pasur nderin dhe kënaqësinë që ta implementojmë një projekt të tillë", tha Presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi.

Prishtinë, 13 tetor 2010 - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), i mbështetur nga GTZ-ja dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë (MTI), organizoi për herë të dytë në Kosovë trajnimin dhe certifikimin e personave për "Ciceronët Turistikë".

Pas disa orëve të njëpasnjëshëm dhe shumë vizitave nëpër Kosovë, 23 kandidatët pjesëmarrës të trajnimit në fjalë me sukses e dhanë provimin dhe më 13 tetor 2010, në hollin e objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), kandidatët pjesëmarrës në një ceremoni solemne i morën certifikatat dhe u certifikuan si "Ciceronët Turistikë".

Gjatë ndarjes së certifikatave rektori i UBT-së Edmond Hajrizi në një fjalë rasti i përshëndeti dhe i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e ceremonisë e veçanërisht përfaqësuesin e GTZ-së, MTI-së, KOTAS-it dhe të USAID-it, dhe tha: "Pas një pune të suksesshme, po e mbyllim një trajnim që për herë të dytë mbahet në Kosovë, pikërisht në UBT, trajnimi për ciceronët turistik. Dhe ne si UBT kemi pasur nderin dhe kënaqësinë që ta implementojmë një projekt të tillë", tha Presidenti i UBT-së, E. Hajrizi, i cili kandidatët e trajnuar për fushën në fjalë si 17 kandidatët e grupit së

parë ashtu edhe kandidatët e pranishëm i vlerësoi me potencial të lartë për prezantim të vendit, dhe shtoi se shpejt do fillojë edhe grupi i tretë.

Po ashtu, gjatë ceremonisë në fjalë të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesi nga GTZ, Ekrem Hyseni tha: "Sot turizmin në

Kosovë ka kush ta prezantojë, qoftë për brenda qoftë për jashtë dhe më vjen mirë që pas GTZ-së janë angazhuar edhe donatorë tjerë për projektin në fjalë dhe i përgëzoj të gjithë kandidatët pjesëmarrës dhe ju uroj punë të suksesshme, duke shpresuar që para të tjerëve ta prezantojnë vendin tonë sa më mirë".

Z. Hyseni ceku se trajnimet për ciceron do vazhdojnë ende. Po ashtu, gjatë ceremonisë i pranishëm ishte edhe Zek Qeku, përfaqësues nga KOTAS-i, i cili tha: "Kam pasur mendime dhe dilema që në Kosovë nuk ka turizëm, nuk ka grupe turistike, nuk ka vizitorë turistikë dhe ju them sinjerisht që ka dhe ka me pas edhe në

të ardhmen, mirëpo fatkeqësia më e madhe në Kosovë është se mungon vetëdijësimi për sektorin e turizmit po edhe në anën tjetër problem që nuk ka pas guida profesionale të certifikuar dhe prej ditës së sotme Kosova ka 40 ciceronë (guida) të certifikuar për ta prezantuar sektorin e turizmit", përfundoi Zek Qeku.



James Berisha vazhdon lobimin për Pavarësinë e Kosovës



Prishtinë, 20 tetor 2010 - James Berisha, i cili e udhëheq Misionin "Fly For Kosovo", në mbështetje të Pavarësisë së Kosovës, në një konferencë për media, ku të pranishëm ishin edhe studentë dhe profesorë vendorë e ndërkombëtare të UBT-së, hapi fushatën për vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Konferenca u zhvillua në sallën e konferencave në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Piloti shqiptaro-amerikan James Berisha, i cili në shkurt i bën dy vjet që fluturon në vende të ndryshme të botës, për të ndikuar që ato vende ta njohin Kosovën, ka thënë se misionin do ta vazhdojë në shtetet e Afrikës, ku do të jetë pjesa më e vështirë e misionit të tij, pasi Afrika ballafaqohet ende me luftëra civile. Ai ka njoftuar të mërkurën, se pas dhjetë ditëve do të fluturojë në kontinentin e Afrikës, për të kaluar në 56 shtetet afrikane. Për ta realizuar misionin e tij "Fly For Kosovo", ai kërkon ndihmë nga donatorë të ndryshëm nga Kosova dhe mërgata.

Pensionistët përballen me kushte të vështira

Filloreta Hasani

STUDENTE NË UBT, MBE, VITI II

Pensionistët në Kosovë vazhdojnë që të jetojnë në gjendje të vështirë. Ata përballen me kushte shumë të vështira socioekonomike, ata tani kanë filluar të humbin shpresat për një të ardhme më të mirë. Shuma prej 45 euro respektivisht 80 euro në muaj nuk u mjafton për asgjë bile as për barna e për gjëra tjera të mos flasim.

Shumica e pensionistëve kosovar kanë një gjendje të tillë, ku tërë ditën e kalojnë në Shoqatën e Pensionistëve, duke pritur se mos televizioni po jep ndonjë lajm për rritjen e pensioneve. Në duart e tyre vërehen gishta të shumtuar nga lëndimet në punë dhe në duar mbajnë qese plot me barna.

Rrëfimet e tyre janë ndër më të ndryshmet. Disa nga ta e kujtojnë me nostalgji kohën në të cilën dinjitetshëm jetonin me pagën e marrë për punën që kryenin. Shumë nga ta të

zhgënjyer me gjendjen e mjerë që kanë shprehin mllef ndaj udhëheqësve se si nuk e kuptojnë gjendjen e tyre por u biren mend për këtë kategori të shoqërisë vetëm në fushta zhgëdhore.

R. Mula është 65 vjet. Sivjet u pensionua. Ai ka punuar në arsim plotë 41 vjetë. Pensioni i tij është 80 euro në muaj. Ai ndihet i lënë pas dore. Dhimjen më të madhe e ndien kur mendon se shumë nga ligjvënës të shkronjat e para i kanë mësuar nga ai, ata në vend se të propozojnë dhe të marrin aksione konkrete për rregullimin e pensioneve të dinitetshme për mijëra pensionist në Kosovë propozojnë privilegje marramendëse për vete. Po të interesoheshin pak gjendja jonë do të ishte më e mire shprehet prof. Mulaj sikur ata të merren me gjendjen reale të pensionistëve e së paku 80% e rrogës të jetë pensioni.

Më tej shprehet më mire edhe ato të holla të mos na japin fare. Ne nuk kërkojmë

mëshirë por kërkojmë vetëm të na jepet ajo që na takon. Po të mendojë se në çfarë gjendje jemi ata do të vepronin ndryshe, por e mban shpresa se një ditë ata do të plaken dhe do vijnë në vitet tona, u shpreh z. Mula.

Marrë në tërsi gjendja e pensionistëve është alarmante por si masë emergjente që duhet ndërmarrë është të nxirret ligji dhe në bazë të ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor të formohet fondi i mirëfillt i pensionistëve dhe të mos vazhdoj gjendja e mjerë e tyre.

Hap tjetër që duhet ndërmarrë është kërkimi i kthimit të fondeve të grabitura nga pushtuesi serb si dhe rishikimi i kontratave të privatizimit posaqërisht ato me spinof special.

Pensionistët mbesin me pak shpresë se një ditë do të bëhet një zgjidhje për ta e ne shpresojmë se ndërgjegjësimi i elites politike një ditë do të do të kthej kokën hah pensionistët se vërtet janë në gjendje të mjerë.



UNIVERSITETI PËR BIZNES
DHE TEKNOLOGJI




UNIVERSITY FOR BUSINESS
AND TECHNOLOGY

INSTITUTI PËR STUDIME EKONOMIKE
INSTITUTE FOR ECONOMIC STUDIES

EKONOMIA ECONOMICS

REVISTË SHKENCORE - SCIENTIFIC JOURNAL



1
2010

Takat e larta, sa të dëshirueshme aq të rrezikshme

Me to keq, pa to keq !

Për pjesën dërrmuese të vajzave në vendin tonë, me theks të veçantë në kryeqendër, takat janë "shoqërimi i ditës". Nëse analizojmë fizikun e tyre në mes të ditës dhe nisim e shohim nga lart-poshtë, një përshkrim i thjeshtë do të ishte: flokët të rregulluar (ose në tentim rregullimi), make up i tepruar, xhinse të ngushta sa më s'ka dhe taka super të larta! Ka edhe të tjera që vishen ndryshe, por ky është "modeli" më i shpeshtë e standard i vajzave "in" sot.

Qëndresa Balaj
dhe Halili Nallbani
STUDENTË NË MBE, VITI II-TË

"Me men n'kry e me sy n'ballë qikat e sotit n'pike t'ditës hypin 20 cantin mi tokë. Jaaaa unë s'pi kuptoj, ja s'jena mirë na, ja me to so diçka n'rregull", shprehet Idrizi, një kalimtar i moshuar rasti. E për ko incidencë pranë Fakultetit Ekonomik të Prishtinës, shkonin e vinin vajza të reja në moshë në taka super të larta, derisa në bisedonim me këtë plak simpatik. Një rastësi tjetër ishte ajo që në zgjedhëm hapësirën e një institucioni arsimor si pikënisje për t'a shtjelluar këtë fenomen shoqëror, e mu në këtë pjesë tak-tak/et e takave nuk kishin të ndalur. "Qa ka lidhje nëse na mathim shtiklla, ato për neve jon maru", shprehet Vlora, një studente, e cila ishte vonë për ligjëratë, e në ato taka njëmend të larta mezi vraponte, e ne shpresojmë që ka arritur aty ku ishte nisur pa u përplasur në ndonjë qytetar rasti. E pyetur nëse ka dëgjuar ndonjëherë që takat shumë të larta, veç që nuk janë të rehatshme, nuk këshillohen edhe nga specialistët, vajza në fjalë, duke shpejtuar hapat na thotë: "Që ma nin mu qa thojn doktorat, për mu me rendësi oshtë mu dok mirë edhe ditën edhe natën". Interesant. Duke vazhduar "rrugëtimin tonë" drejtë universiteteve tjera si publik ashtu edhe private në Prishtinë, takuam një tjetër vajzë të veshur në modelin e thënë në hyrje të këtij teksti. E rregulluar sa më s'ka në 12 të ditës, takat e saj nuk e linin të ecte drejt, edhe pse bora ishte



shkrirë e "terreni" tashmë ishte i pastër. E pyetur: "A po mundesh me ec?", ajo na kthehet duke buzëqeshur: "Po more, veç i kom vesh qizmet e motrës e po m'vraja pak", flet lirshëm, Arta, studente dhe shitëse e një supermarketi. E çka i shtyn femrat që takat t'i kenë shoqërimin e gjatë gjithë ditës. "Tybe frajeri jem o ma i gat se unë, e për me mri pak mathi shtiklla, po edhe kur s'kom pas frajer kom vesh se krejt shoqet e mija i kanë pas qef shtikllat gjithë, e edhe unë i bajsha se mu doke vetja si xhuxh kur isha me to",

tregon Arta. Duke vazhduar "shëtitjen" tonë, takojmë Elsën, një vajzë që me shumë insistim e bindëm të flasë me ne. E veshur në pllaninka, një palltë të zezë të trashë dhe xhinse, ajo duke e qetë shprehet: "Nuk e di a jom unë njeri adekuat që muj me fol për këtë temë, po nuk po m'doket n'rregull me vesh taka vend e pavend qysh moshataret e mia pi veshin. Për me qenë shumë e singertë unë nuk i baj për çdo ditë, n'mramje po shumë rrallë. Jo pse nuk m'pëlqejnë po si 20 vjeçare nihna ma mirë n'patika, po edhe atyre ju vjen

koha". Një tjetër kalimtar, po kësaj radhe një djalë i ri, i pyetur a i pëlqejnë më shumë femrat me apo pa taka shprehet: "Me t'kallxu drejt dove ju rrinë mirë, po do do që me mëngjes ta nxjerrin gjumin tu bo tak-tak s'muj mi duru", shprehet Agroni.

Taka e lartë dëmton boshnin kurrizor dhe shtrembëron këmbën

Pavarësisht realitetit e këndvështrimit të qytetarëve, specialistët e kësaj fushe, duke ju referuar anës profesionale tregojnë të mentat

dhe përparësitë që kanë takat. "Taka shumë e lartë dëmton boshnin kurrizor, shtrembëron këmbën prej gjurit e poshtë dhe nuk të le të ecësh shpër dhe sigurtë", shprehet Luan Vokri, specialist i kësaj fushe. "Edhe pse takat e larta nuk preferohen, për shkak të efekteve të tyre anësore, as këpucët krejt të rrafshata nuk janë në favor të shëndetit. Ne preferojmë që këmba e femrës të qëndrojë 3 cm mbi tokë në mënyrë që gjaku të qarkullojë lirshëm. Kjo në veçanti këshillohet për vajzat që kanë problem me vena", thekson dr. Vokri.

I pyetur si e sheh "sindromën" e takave të larta në vendin tonë, nga rrafshi profesional, ai shprehet: "Fakti më shqetësues për mua është që vajzat shumë të reja në moshë sot veshin taka të larta. Vec që nuk u kanë hije për moshën që kanë, problemet me shputën dhe qarkullimin e gjakut të to nisin shumë më herët". Edhe për syrin edhe për shëndetin takat e larta nuk janë të preferuara, por vajzat sot ikin nga ky realitet, pa e ditur saktë pse "çmenden" pas tyre. Është e pamohueshme që taka të bënë të dukesh edhe më femër, por edhe ajo e ka vendin dhe kohën e vet. Krejt në fund, këshilla e z. Vokri për vajzat është: "Vishni taka por jo shumë të larta, jo çdo ditë dhe në çdo orë, jo taka që nuk janë stabile. Nuk është e preferueshme t'i ndërtoni këpucët mes vete. Sidoqoftë zgjedhja ju mbetet juve, por edhe pasojat do t'i bartni vetëm ju!"

Komuna e Prizrenit falënderon UBT-në

Prishtinë, dhjetor 2010 – Kuvendi Komunal i Prizrenit e ka falënderuar Universitetin për Biznes dhe Teknologji lidhur me trajnimin e kandidatëve për Ciceron turistikë të

Komunës së Prizrenit e mbajtur në hapësirat e UBT-së.

Në letrën falënderuese të Shpend Kabashit drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm KK Prizren thuhet se paraprakisht ju falën-

derohem për përkrahjen që ju si universitet i keni dhënë disa studenteve nga Prizreni me ç'rast ishin pjesëmarrës në trajnime të organizuara nga UBT-ja për Ciceron turistikë, ku kanë treguar suk-

ses të lartë në këtë fushë..

Duke e parë punën e kandidatëve të trajnuar dhe prezantimin e tyre, interesim të madh kanë shpreh edhe disa të rinj qytetit tonë të vijojnë trajnim për

ciceron dhe pikërisht në UBT thuhet ndër të tjera në letrën falënderuese të Kuvendit Komunal të Prizrenit drejtuar Universitetit për Biznes dhe Teknologji.

Trajnime dhe certifikime profesionale



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqum Comunitare e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatike
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAX - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhinieringu i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenju Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim

Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Roli i TQM (Total Quality Management) në Zhvillimin e NVM-ve në Kosovë



Msc. Arton Celina

Republika e Kosovës një shtet i sapoformuar, pas një dekade e mbështetur në donacione të huaja dhe të hyrat nga diaspora është duke kaluar nëpër fazat kritike për formimin e një fundamenti të shëndoshë për zhvillimin ekonomik të vet shtetit. Sfidat janë të panumërta në shumë aspekte, por esenca qëndron në ngritjen e kapaciteteve të sektorit privat për të bërë konkurrencë importeve nga vendet e regjionit si dhe pjesëmarrja e tyre në tregjet internacionale në mënyrë që të zgjerohen kapacitetet prodhuese të ndërmarrjeve tona.

Në anën tjetër, forcat e globalizimit nga të gjitha anët shtojnë presionin në ndërmarrjet tona që me një ritëm të shpejtuar ti përqafojnë standardet ndërkombëtare të menaxhimit dhe cilësisë në

mënyrë që të jenë më të pranueshme nga tregjet rajonale dhe ato internacionale në përgjithësi.

Njëra nga filozofitë menaxheriale e cila është treguar shumë e suksesshme dhe i ka udhëhequr kompanitë Japoneze pas Luftës së Dytë Botërore drejt suksesit absolut dhe po ashtu është përqafuar me vonë edhe nga shumë korporata amerikane dhe evropiane është filozofia e quajtur Menaxhimi i Kualitetit të Përgjithshëm (TQM). Kjo filozofi e paraqitur për herë të parë nga profesori amerikan De Ming në vitin 1940, nënkupton prodhimin e shërbimit kualitativ në bazë të definimit të konsumatorëve. Është një filozofi e cila është e definuar si e përqendruar në kualitete të përgjithshme, e fokusuar tek konsumatori, e bazuar në fakte, e orientuar në punë ekipore, e udhëhequr

nga menaxhmenti i kualifikuar për ti arritur objektivat strategjike të cilat duhet të kenë në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve, kualitet të rangut botëror dhe e mbështetur në mësimin gjatë gjithë jetës (lifelong learning).

Pse është e rëndësishme TQM për kompanitë kosovare?

Globalizimi i ambientit të biznesit domosdoshmërisht ka përshpejtuar procesin e integritimit të tregjeve botërore. Ekspansioni i kompanive multi-nacionale përmes depërtimit të tregjeve të reja ka sfiduar implementimin e standardeve të harmonizuara të cilat do të mundësonin unifikimin të konsumatorëve të të gjitha tregjeve anë e kënd botës. Implementimi i standardeve mundëson në masë të mëdha që jeta e njerëzve të jetë më

lehtë duke lejuar që produktet unifikuese të mundësojnë aplikimin e tyre të njëjta në të gjitha tregjet.

ISO Standardet

ISO Standardet janë një rrjet i 148 shteteve me një sekretariat të përbashkët që ndodhet në Gjenevë të Zvicrës i cili e kontrollon sistemin e standardeve në tërësi. Aplikimi i këtyre standardeve për të gjitha kompanitë botërore do të thotë që furnitorët në përgjithësi kanë mundësi të ofrojnë produkte të tyre të cilat janë të aplikueshme në pothuajse të gjitha tregjet botërore, dhe kjo e bën prodhuesin si ndërmjetësues dhe konsumatorin si përdorues final shumë më të besueshëm dhe i ndihmon në vendimmarrje shumë më të lehtë për aplikimin e këtyre produkteve.

Perspektiva kosovare

Në përputhje të asaj që u tha

më lartë, duke i inkorporuar të gjitha elementet e TQM-së, nëpërmes aplikimit të standardeve të përgjithshme ndërkombëtare ISO, NVM-të kosovare do të mund të bënin hapa signifikant drejt depërtimit të tregjeve ndërkombëtare, e sidomos duke qenë anëtare të marrëveshjes së CEFTA-së dhe duke pretenduar të qenit anëtar i shumë organizmave ndërkombëtare. Ky sistem i menaxhimit do të kishte aplikim të gjerë në NVM-të tona duke marrë parasysh potencialet e shumta që Kosova ka në shumë sfera.

Ky punim është paraqitur në konferencën "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010. Autori i punimit në fjalë është alumni dhe mësimit në UBT.

Mrs. Eleanor Pritchard involved in the development of the relationship between City and UBT

UBT can make a contribution to the tertiary education sector in Kosovo

I support fully the academic and international development plans being led by the Vice President which will strengthen UBT's core business, that is, the university activities, and bring tangible benefits to the institution, staff and students, says Eleanor Pritchard

N. Demiri

UBT News: Mrs. Eleanor Pritchard can you say something shortly about yourself and your professional engagement?

E. Pritchard: I am here to carry out fieldwork for a socio-legal research project, which investigates Kosovo's unique legal history and the legacy of multiple legal systems in contemporary Kosovo.

UBT News: Mrs. Pritchard you decided to be part of UBT, how?

E. Pritchard: I first visited UBT three years ago as part of an evaluation exercise carried out by the Ministry of Education and have kept in touch with the President since then. I am not employed by UBT, but I am grateful that the President has welcomed me during this period of research as a friend of the institution. While here for my own research,

UBT News: What do you work more concretely in UBT?

E. Pritchard: As well as my academic experience, I have a professional background in academic administration, quality

assurance, accreditation, and the development of educational partnership programmes and am making contributions in these areas. As a Visiting Fellow at City University, London, I am involved in the development of the relationship between City and UBT. I have also been supporting some undergraduate social science students who are preparing their dissertations. I was pleased to take part in the first series of Academic Speeches organized by the Vice President, in which I had the opportunity to present my research and methodology, and discuss both with UBT's academic staff.

UBT News: How many support you find for realization of projects or your plans inside UBT?

E. Pritchard: Within UBT, I am particularly grateful to Prof. Limani, whose support and encouragement for my research has been invaluable and to Binak Beqaj, the Director of Academic Affairs, whose patience with my questions about language and culture is remarkable. More broadly, the Minister of Education, and the Director of Academic Affairs have been very supportive of my research project, which I



greatly appreciate.

UBT News: In general which is your opinion for the work here in UBT?

E. Pritchard: I think UBT has some interesting ideas, and can make a contribution to the tertiary education sector in Kosovo. I support fully the academic and international development plans being led by the Vice President which will strengthen UBT's core

business, that is, the university activities, and bring tangible benefits to the institution, staff and students.

UBT News: Which are your plans in the future, and what are the plans for UBT in 2011?

E. Pritchard: I have completed most of the background work for my research project, and will start my fieldwork in

2011. This will mean my spending more time out of Prishtina; however, as most of the contributions I make to UBT relate to documentation, and can be done electronically, this shouldn't make much difference to my involvement with the institution. Also, I have just started some teaching at the University of Prizren, and look forward to continuing with this in the New Year.

UBT certifikon edhe 20 kandidatë për ciceron

Prishtinë, 25 nëntor 2010 -

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), i mbështetur nga GTZ-ja dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë (MTI), organizoi për herë të tretë në Kosovë trajnimin dhe certifikimin e personave për "Ciceronët Turistikë".

Pas disa orëve të njëpasnjëshëm dhe shumë vizitave nëpër Kosovë, 20 kandidatët pjesëmarrës të trajnimit në fjalë me sukses e dhanë provimin dhe më 25 nëntor 2010, në hollin e objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), kandidatët pjesëmarrës në një ceremoni solemne i morën certifikatat dhe u certifikuan si "Ciceronët Turistikë".

Gjatë ndarjes së certifikatave rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi në një fjalë rasti i përshëndeti dhe i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e ceremonisë e veçanërisht përfaqësuesin e GTZ-së, MTI-së, KOTAS-it dhe të USAID-



it, dhe tha: "Pas një punë të suksesshme, po e mbyllim një trajnim që për herë të tretë mbahet në Kosovë, pikërisht në UBT, trajnimi për ciceronët turistikë. Ne si UBT kemi pasur nderin dhe kënaqësinë që ta implementojmë një projekt të tillë", tha Presidenti i UBT-së, E. Hajrizi, i cili

kandidatët e trajnuar për fushën në fjalë, si 17 kandidatët e grupit të parë, 23 kandidatët e grupit të dytë, ashtu edhe 20 kandidatët e pranishëm, i vlerësoi me potencial të lartë për prezantim të vendit dhe shtoi se UBT është në përpjekje të fillorë edhe grupi i katërt.

Po ashtu, gjatë ceremonisë në fjalë të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesi nga GTZ, Ekrem Hyseni tha: "Sot, turizmin në Kosovë ka kush ta prezantojë goftë për brenda goftë për jashtë dhe më vjen mirë që pas

GTZ-së janë angazhuar edhe donatorë tjerë për projektin në fjalë, dhe i përgëzoj të gjithë kandidatët pjesëmarrës dhe ju uroj punë të suksesshme, duke shpresuar që para të tjerëve ta prezantojnë vendin tonë sa më mirë", tha z. Hyseni. Po ashtu gjatë ceremonisë i pranishëm ishte edhe Fatos Hamza, përfaqësues nga KOTAS-i, i cili tha: "UBT është ndër Universitetet e para në Kosovë, i cili ka vërejtur se ciceronët e kualifikuar janë shumë të rëndësishëm, sepse në të njëjtën kohë e rrisin edhe ekonominë e vendit, dhe UBT falë punës së saj precize, ka arritur ta zhvillojë projektin në përpikëri", citoi Fatos Hamza.

Po ashtu, një fjalë rasti e mbajti edhe Prof. Dr. Hivzi Muharremi, mësimdhënës në UBT. Ai tha se të certifikuarit kanë për ta prezantuar Kosovën në të gjithë sektorët si në kulturë, ekonomi, etj.

Në UBT u prezantuan dy hulumtime si *Shitësitë ambulante dhe Tregtia ndërkombëtare e mishit në Kosovë*

Definimi i tarifave për terminim të trafikut ndërkombëtar

MSc. Fatos Bakalli

Të hyrat që operatorët e telefonisë mobile i realizojnë nga terminimi i trafikut ndërkombëtar, paraqesin një element shumë të rëndësishëm në të hyrat e gjithëmbarshme të këtyre kompanive. Në shumë raste, vlerat e të hyrave të realizuara nga ky trafik, shkojnë nga 15 deri 20% në të hyrat e përgjithshme. Andaj, përcaktimi i favorshëm i këtyre tarifave (ITTR), do të ketë impakt të konsiderueshëm në të hyrat e operatorëve të telefonisë mobile.

Operatori mobil VALA, në një moment të caktuar erdhi në situatë për ta rinegocuar ITTR-në me Monaco Telekom, si donuesi i numeracionit - kodit ndërkombëtar (CC- Country Code – 377 44 dhe 377 45) dhe atij Mobil (MCC - Mobile Country Code – 212 01). Duke mos pasur qasje në tregun e trafikut ndërkombëtar të telekomunikacionit, u dashtë që, duke u bazuar në tarifën që Monaco Telekom aplikonte për thirrjet ndërkombëtare në shkuarje, me një analizë dhe qasje shkencore, të definohej se cila tarifë (ITTR) do të ishte më e pranueshme nga të dy palët negociuese.

Qasja përmes Analizave të Vendimmarrjes (Decision Analysis approach)

"Analiza e vendimmarrjes si disiplinë shkencore, mundëson që marrja e vendimeve për probleme të vështira, përmes ndjekjes së disa procedurave dhe hapave të caktuar transparent, të shndërroj këto probleme në probleme transparente dhe të kuptueshme", citon Ronald A. Howard, Decision Analysis: Practice and Promise, Management Science,



Vol. 34, No. 6).

Teoria e Analizës së Vendimmarrjes rekomandon që të ndjekë hapat si më poshtë si definimin e problemit, grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, përcaktimin e modeleve, dhe skenarëve të mundshëm, përcaktimin e probabilitetit për secilin nga modelet / skenariot, renditja e këtyre modeleve/scenarëve dhe marrja e vendimit.

Duke u nisur dhe ndjekur hapat e cekur më lartë, e lidhur me problemin në fjalë, është vepruar si në vijim dhe të dhënat të cilat janë marrë në konsideratë kanë qenë si të dhënat historike (sipas muajve dhe viteve të shkuara) mbi vëllimin total të trafikut ndërkombëtar në ardhje, të dhënat historike mbi vëllimin e trafikut ndërkombëtar në shkuarje sipas destinacionit (shtetit) dhe tarifën ndërkombëtare që VALA

i paguan Monaco Telekomit sipas destinacionit.

Analiza është fokusuar në dhjetë shtetet si në Gjermania, Zvicër, Shqipëri, Maqedoni, Austri, Itali, Britania e Madhe, Slloveni dhe Kroacia, që mbartin mbi 80% të trafikut ndërkombëtar në shkuarje (parimi Pareto), dhe duke mos pasur të dhëna për trafikun në ardhje sipas destinacionit. Është supozuar që përqindja e pjesëmarrjes së trafikut në shkuarje kah një destinacion i caktuar të reflektoj në përqindje të njëjtë në trafikun në ardhje nga ky destinacion.

Duke u bazuar në tarifën në shkuarje sipas destinacionit dhe përqindjes që destinacioni i caktuar merr në trafikun total, është përlogaritur vlera mesatare e tarifës për thirrje ndërkombëtare në shkuarje. Duke aplikuar këtë tarifë të përlogaritur dhe duke supozuar tri vlera për margjinën që Monaco Telekom aplikon në vlerën mesatare të tarifës, janë ndërtuar tre skenarë të mundshëm – tre vlera të përlogaritura për tarifën e kërkuar për terminim të trafikut (ITTR).

Përcaktimi i probabilitetit për secilën nga skenarët e ndërtuar është bërë përmes metodës së "krahasimit të qifteve" (Paired Comparison Methodology)

Së fundmi, me vendosjen e vlerave sipas skenarëve dhe probabiliteteve të përlogaritura për këto skenarë në "Decision Tree" është përcaktuar vlera referente për ITTR.

Sipas kësaj qasjeje, ka rezultuar se tarifa ITTR që duhet të dakordohen të dy palët negociuese (VALA dhe Monaco telecom) duhet të silltet nga €0.14 deri €0.16 për minutë të terminuar në rrjetin Vala.

EPILOGU

Pas negociatave të gjata dhe të mundimshme, marrëveshja e arritur për tarifë të terminimit të trafikut ndërkombëtar në ardhje (ITTR) ishte €0.145/min, që dëshmon se qasja sistematike e prezantuar ishte qasje e duhur dhe vendimi për të negociuar në diapazonin €0.14 deri €0.16 ishte vendim i drejtë. Rezultat i tarifës së re të dakorduar ishte shtimi i të hyrave të VALA-s për mbi €15 Mil në vit, krahasuar me të hyrat e realizuara para definimit të ITTR në vlerë €0.145/min.

Autori i tekstit MSc. Fatos Bakalli, punimin e përmbyll me thënien e Robert T. CLEMENT. "Qasja e zgjidhjes së një problemi nga aspekti i Analizës së vendimmarrjes nuk rrit fatin e vendimmarrësit, por mundëson që problemi të kuptohet më mirë dhe si rezultat edhe të marrim vendime më të mira. Pavarësisht nga kualiteti i vendimit që marrim, rezultatet e vendimeve tona mund të jenë të favorshme apo të pafavorshme, por aplikuar metodologjinë e Analizës së vendimmarrjes, vendimmarrësi asnjëherë nuk do të befasohej nga një rezultat i pafavorshëm", ROBERT T. CLEMENT (1990) Making Hard Decisions – An introduction to decision analysis, Duxbury Press – Belmont, California - USA.

Autori është alumni i UBT-së, dhe aktualisht është në VALA, si menaxher i Departamentit të Menaxhimit të Produkteve. . Kjo ese është përmbledhje e punimit shkencor që autori ka prezantuar në "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010.

Studentët e UBT-së përfunduan praktikën në Kompaninë Tregtia

Prishtinë, 15 dhjetor 2010 – Në hollin e objektit të Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), u zhvillua ceremonia e ndarjes së certifikatave për Internship për studentët e Fakultetit të Arkitekturës të cilët e kanë përfunduar praktikën në kompaninë Tregtia.

Certifikatën studentëve ua ndanë, presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi, Dr. Can. Binak Beqaj si dhe z. Mërgim Prishtina, pronar i kompanisë

Tregtia.

Z. Prishtina, studimet post-diplomike i ka përfunduar në UBT, në Departamentin IEME.

Gjatë kësaj praktike u vlerësua se studentët kanë treguar rezultate të mira në orët e parapara për kompletimin e këtij Internshipi dhe ato në tre fusha: Menaxhim i projekteve në ndërtimtar, projektim arkitektonik dhe mbikëqyrja e punimeve.

15 studentët të cilët u pajisën me certifikata janë:

Burim Ramadani, Afërdita Gjinolli, Albana Hasani, Egzontina Shabaj, Njomza Havlli, Arafat Basha, Rinor Kryeziu, Erden Halili, Yllza Lutfiu, Shaban Rrahmani, Blerta Bytyqi, Nazmi Mazreku, Qëndresa Gashi, Endrit Majtazi e Texhedin Avdija.

Vlen të theksohet se, përveç bashkëpunimit me Tregtinë, UBT ka një numër të madh të bashkëpunimeve me kompani private, si vendore dhe ato ndërkombëtare.



Valmiri, lojtar i Superligës së Kosovës



„Si futbollist kam filluar në ekipin „Trepçen 89” nga Mitrovica, dhe jam ende në këtë ekip”, thotë Valmir A. Fejza, i cili studion në UBT, Departamenti i Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi. - “Me futboll kam filluar të merrem qysh në moshën gjashtë vjeçare, e më pas fillova të luaja për ekipin

në fjalë dhe vazhdoj ende të luaj për këtë ekip”, vazhdoi Fejza. Valmiri mendon së në të ardhmen do të vazhdojë të luajë, por edhe të punojë në profesionin si ekonomist. Ai ka fituar disa mirënjohjeve, por deri tash e veçon sezonin e fundit, kur ekipi mitrovicas u rikthye në Superligën e Kosovës.

Dua të garoj në kampionatin e ardhshëm botëror



Flakon Musliu, studentë i vitit të II-të, në Fakultetin Menaxhment, Biznesi dhe Ekonomi në UBT. Përveç studimeve merret edhe me sport pikërisht me skijim që nga moshën 13 vjeçar. “Në disiplinën e sllallomit të vogël dhe sllallomit të madh dhe aktualisht i mbroj ngjyrat e klubit “Ferizaj” nga Kosova”, tha Flakoni. Gjate këtij fund viti dhe fillim të vitit 2011 priten të mbahen garat në Brezovicë, aty edhe Flakoni

është pjesëmarrës në sllallom të vogël po ashtu në sllallom të madh. Flakoni nuk i kanë munguar as mirënjohjet në këtë drejtim, ku në vitin 2006 në garën “Freestyle” e cila u mbajt në Brezovicë. “Dua të jem pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë Dimërore të 2014, dhe të garoj në kampionatin e ardhshëm botëror në 2011 në Bavaria të Gjermanisë”, përfundoi Flakon Musliu.

Besim Mydyti - student, fotograf dhe kompozitor

“Në muajin që jemi jam ftuar në spektaklin ku do zgjedhet Miss Globe Internacional 2010, në Turqi. Atje do të jem si drejtor nacional i Miss Globe Kosova po ashtu edhe si fotograf, ku do t’i fotografoj rreth 80 vajza të cilat janë në konkurrim”, tha Besim Mydyti, student në Fakultetin Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), për gazetën „UBT News”

„Kohëve të fundit kam fotografuar organizime të ndryshme, si “FTV Party” që u mbajt në Prishtinë, në Malin e Zi dhe në Shqipëri, pastaj Miss dhe Mister Kosova, Miss Coppacabana, Miss civilization of the World, sfilita të ndryshme, etj. Po në muajin që jemi do të organizohet “FASHION TV PARTY”, i licencuar nga Fashion TV dhe e organizuar nga Kosova Models, ku unë do të jem fotograf zyrtar. Pastaj, në muajin që jemi jam i ftuar në Miss Globe Internacional i cili do të mbahet në Turqi. Atje do të jem si drejtor nacional i Miss Globe Kosova poashtu edhe si fotograf, ku do t’i fotografoj rreth 80 vajza të cilat janë në konkurrim”, tha B. Mydyti, po ashtu Besimi në vazhdimësi fotografon konferencat dhe ngjarjet më të mëdha që organizon Universitete ku studion ai.

Me ndihmën e fotografisë ka arritur të bëhet drejtor nacional për Miss Globe Kosova

„Pas fotografimeve të organizimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, të cilat të gjitha i kam publikuar në uebsite, aty me kontaktuan nga qendra e Miss Globe Internacional. Isha i ftuar të bisedoj në lidhje me këtë organizim dhe si rezultat me dhanë licencën për Miss Globe Kosova”. thotë Besimi, i cili shton se për shkak të marrjes së licencës më vonë, sivjet nuk patën mundësi të organizojnë Miss Globe në Kosovë, por pas disa takimeve me vajzat që kishin konkurruar për Miss Globe Kosova, vendosen që këtë vit Kosovën ta përfaqësoj Mirjeta Shala nga Vushtrria. Po ashtu Besimi ka edhe një ftesë nga Charlies Models nga USA për bashkëpunim.

Besimin e gjejmë edhe në muzikë

Besimi ka bërë kompozime të ndryshme dhe ka marr pjesë nëpër festivale të shumta ku ka rrëmbyer disa çmime. Çmimet e fituara janë si në vitin 2008 fiton çmimin kryesor “Zambakun e argjendte” në festivalin



Zambaku i Prizrenit, poashtu në 2007 ka qen fitues i vendit të trete si kompozitori më i mirë, ku dhe kënga fituese në këtë festival ishte e orkestruar nga ai. Në vitin 2005 ka fituar vendin e pare në festivalin e muzikës zbavitëse “Ferfest”

në Ferizaj, etj.

Me përfundimin e studimeve në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Besimi mendon të krijojë një ekip ose më mirë të themi një shkollë ku do krijojnë programim, uebfaqe, design, fotografi, etj.

Studentët e UBT-së zhvillojnë aktivitete humane

Prishtinë, 13 dhjetor 2010 - Për nder të festave të fundvitit, studentët e UBT-së, përveç aktivitete të përditshme, gjatë këtyre ditëve kanë marr përsipër ta zhvillojnë edhe një

aktivitet ose projekt me karakter human.

Ky aktivitet, ka për qëllim të ju vie në ndihmë familjeve që janë në gjendje të rëndë ekonomike në rrethinën e

Komunës së Prishtinës edhe atë të Fushë Kosovës, përfshirë 25 familje.

Kandidatët nuk janë të obliguar të participim më të holla, por me vetë dëshirë dhe sipas

mundësisë së tyre.

Mjetet grumbullohen në bashkëpunim me Kryesin e grupit të fakulteteve përkatëse të UBT-së

Data e fundit për participim

e të hollave është 21 dhjetori 2010, kurse shpërndarja e tyre bëhet në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës, dhe shpërndahen më 27 dhjetor 2010.

Brand Equity in Low-Involvement Products

Berat Thaqi

While I was thinking how to start this writing, immediately came to my mind powerful brands like: Harley Davidson, Nike, Milka, Iphone and really consider these brands symbols of our lifestyle and not merely as products. Today branding is used to impact customers, employees, government and investors and in average we pay 20-25 % more as premium price for strong brands. Because of the powerful influence of branding concepts in our perception and profit making, I conducted a research with the purpose to understand whether a low involvement product category when difference among competing brands it is not very obvious can create brand equity.

According to Keller K.L and Lehman D.(2008), brand equity arises when it is seen as distinctive in a positive and important ways in the minds of customers, so the brand can be thought as a promise to the customers, and it's association has important implication what brand can and cannot do. Low involvement products are those products in which consumers do not consider the product very important and do not strongly identify with it (Assael H., 2004). Aaker D. defines brand identity as "a unique set of brand associations that brand strategists aspire to create or maintain". In order to answer the questions raised in my research I chose a product as a case study, and interviewed 25 prospects of the product and the company's manager. Product is spring water "Uje Rugove", which is a low involvement product because among others does not include any risk for consumer, it is cheap

and does not have a badge value. Results showed that in many dimensions of brand equity such: brand awareness (100%), perceived quality (88%), association/differentiation (80%), satisfaction (90%), and price premium (60%) a low involvement brand can create strong equity. This dimensions are very important because: 1) by only being aware of the name of a brand customer perceive it as more qualitative, 2) perceived quality affects Return On Investment more than marketing expenditures and R & D, 3) high differentiation means higher premium price. Also, the same brand which competes in a product category when functional benefits differences are not easily noticed or not noticed at all, can built a distinct brand identity by using sources beyond his functional benefits e.g. place of origin. By using Big Five Personality Scale, I also asked participant to describe Uje Rugove personality which mostly is described in words: All-Kosovar, Original, Trendy, Family-oriented, Athletic, Trustworthy, Cool and Leader.

This research leads to some implications for Uje Rugove, theory and future researches. In general, theory should give more importance regarding relationship between the level of product involvement and brand equity. While for Uje Rugove, it should further distinguishes himself from competitors by using more sources of brand identity and use brand personality as an extended brand identity. Regarding future research, a higher number low involvement products and a bigger sample of participants may offer more facts regarding brand equity in low involvement products.



E ardhmja e Facebook-ut

Pajtim Thaqi

Mark Zuckerberg është drejtor ekzekutiv i një kompanie gjigante në moshën 28-vjeçare. Facebook është web faqja më e popullarizuar pa pagesë për rrjetëzim shoqëror (social) botëror, e cila lejon shfrytëzuesit të krijojnë profile, ngarkojnë fotografi dhe video, dërgojnë mesazhe dhe të jenë në kontakt me miqtë, familjarët dhe kolegët e tyre.

Puna e kësaj faqeje ka filluar më 4 shkurt 2004.

Ndihmon për të zbuluar më shumë persona të cilët gjenden në të njëjtin grup të rrjetit, kjo faqe kishte rritje galopante anëtarësh, ku deri më tani numri i anëtarëve është mbi 500 milion.

Shumë anëtar hynë apo hapin llogari (account ang.) në faqe për të thyer monotoninë dhe veprimi i aktiviteteve të reja dhe ndryshimi i kohës së përdorimit të internetit, por ka edhe shumë raste të tjera përshkak të keqpërdorimit të fotografive etj.

Është një rast i volitshëm për t'u lidhur me njerëz dhe grupe të ndryshëm personash si: thirrës, nxënës dije, dijetarë, shkrimtarë, gazetarë, politikan, shumë biznese që pretendojnë



me hap uebe të ndryshme për të reklamuar produktet e tyre ata do të kursejnë dhe do të

krijonin një grup reklamimi në facebook në mënyrë të drejt-përdrejtë dhe pa ndërmjetës, ju

jep mundësi anëtarëve të saj që të shkruajnë dhe shkëmbejnë fotot dhe mendimet e tyre të shkurtra për njohje në mes dy gjinive.

Sipas një studimi, i cili zhvillohet çdo vit, që prej 1997-ës, të rinjtë, sidomos vajzat, kërkojnë të kenë një shoqëri të madhe.

Përdorimi i kompjuterit dhe i internetit mes të rinjve, nga viti 2000 e deri më sot, është rritur në mënyrë konstante e të vazhdueshme, për ata anëtarë të cilët dëshirojnë të përdorin Facebookun për të komunikuar në mënyrë private, ekziston funksioni i mesazheve, që është i ngjashëm me funksionimin e emailit, ku bisedimet nga çati (chat ang.) dhe mesazhet përdoren nga 75% e të rinjve dhe rreth 80% janë frekuentues të rregullt të YouTube – it për të shpërndarë (share ang.) muzikë dhe video nga më të ndryshmet, ku postojnë gjëra interesante në murin e tyre mënyrë që të pëlqehet dhe që të kenë sa më shumë miq.

Tani më kompjuteri është bërë një mjet tepër personal, në kuptimin që shumica e të rinjve e kanë në dhomën e tyre ose ka do që shkojnë kyçen me wireless me loptop apo telefon

mobil dhe një përqindje e madhe e të rinjve, navigojnë në internet në orët e vona të natës, para se të bjerë për të fjetur.

Pra shumë të rinj kalojnë mesatarisht 4-5 orë në ditë para ekranit të një monitori apo kohëve të pushimit mund të ndodh që edhe tërë ditën.

Pangopësia në shfletimin e kësaj faqeje dhe kalimi i kohës së gjatë në përdorimin e saj duke formuar lidhje, njohje, lojëra mesazhe, vëzhgimi i pjesëve video, çatit, etj., veçori të cilat i servir facebook-u për anëtarët e tij.

Kompjuteri dhe interneti mund të zëvendësojnë një mik, dashurinë, komunikimin me njerëzit e gjallë, jetën reale. Interneti shformon realitetin, duke qenë në shërbimin e tij, ku të rinjtë rrezikojnë të bëhen viktimat e tij, se një botë virtuale e pakontrolluar mund të jetë shumë e rrezikshme.

Mirëpo, sot po rritet një brez që është shumë i lidhur me botën virtuale. Me përdorimin e kompjuterit dhe internetit, truri i tyre funksionon ndryshe. Problemi nuk qëndron te vendosja e limiteve, por te fakti që ta integrojmë jetën në fushën digjitale me raportin njerëzor.

Konferencë me rastin e Ditës Botërore të standardeve

“Quality Kosova” anëtarësohet në “Organizatës Evropiane për Cilësi”

“Ne si institucion universitar kemi themeluar organizatën Quality Kosovav (QK). Përmes kësaj organizate sot Kosova është anëtarësuar në Organizatën Evropiane për Cilësi (EOQ), tha Presidenti i UBT –së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në Konferencën e Ditës Botërore të standardeve, të mbajtur në Prishtinë.

Prishtinë, 19 tetor 2010 - “Duke e parë rëndësinë e cilësisë dhe të standardeve në Kosovë, ne si institucion universitar kemi munduar dhe kemi marrë iniciativën me themelu organizatën Quality Kosova (QK). Përmes kësaj organizate sot Kosova është anëtarësuar në Organizatën Evropiane për Cilësi (EOQ). Të gjitha vendet e zhvilluara kanë organizata të tilla, të cilat mundohen ta promovojnë cilësinë e vendit të vet, dhe me themelimin e organizatës në fjalë, edhe Kosova sot është karshi tyre”, tha Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në konferencë me rastin e Ditës Botërore të standardeve, të organizuar nga Agjencia e Standardizimit - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Po ashtu, gjatë konferencës



kjo agjenci ka prezantuar katalogun e saj me mbi 3.100 standarde të miratuara e që tash janë në shërbim të bizneseve vendëse. “Prodhuksi kosovar do të jetë më shumë i pranuar në tregun ndërkombëtar dhe

vendas vetëm duke i pranuar standartet evropiane dhe ndërkombëtare që tashmë janë të njohura si standarde kosovare. Tregu evropian mund ta mposhtet vetëm me produktet kosovare, vetëm me plotësimin

e standardeve”, ka thënë kryeshafi i Agjencisë së Standardizimit të Kosovës, Hafiz Gara.

Katalogu i standardeve kosovare, ngërthen në vete të gjitha standartet e miratuara

kosovare që janë në përputhje me ato evropiane dhe ndërkombëtare, standartet për ndërtim, shërbime postare, derivatet për energji, përpunim i drurit, shëndetësi, makineri, tekstil etj.

Gurakuq Kastrati bëri prezantimin e “Direktivat e BE-së që kërkojnë të kenë shenjën ‘CE’. Ai tha se duhet të bëhet shumë punë që Kosova të jetë në krah me vendet e BE-së për sa i përket standardizimit të produkteve.

Sipas tij, direktivat e BE-së për harmonizim kanë kërkesa themelore që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë e produkteve, që duhet t’i plotësojnë për t’i plasuar në treg.

“Kërkesa për produkte duhet të jetë e harmonizuar me standarde evropiane për plasim në treg. S’do mend se produktet duhet të jenë të standardeve të larta për t’i pranuar BE-ja”, tha ai.

Anketë me studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi dhe Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT

Planet për vitin 2011?

Të anketuarit tanë thonë se gjatë vitit 2011 kanë shumë plane për të realizuar, por ajo të cilën e veçojnë është përfundimi me sukses i studimeve, vizitat e tyre nëpër institucione prestigjioze, përvetësimi i gjuhëve të huaja dhe bizneset e tyre familjare të ecin mbarë.

Liridon Zeqiri



Planet që mendoj ti realizoi janë si dëshiroj që studimet themelore në UBT ti vazhdoi dhe ti përfundoj me sukses të shkëlqyer. Po ashtu, plan tjetër imi është edhe vazhdimi i studimeve mastër në universitete të njohura p.sh në ato universitete ku UBT-ja ka marrëveshje bashkëpunimi dhe që ka kontakte të mira me to, pjesëmarrje nëpër seminare dhe ekskursione të ndryshme etj.

Suad Ejupi



Kam plane të ndryshme për vitin 2011, por ajo që vlen të veçohet është përfundimi i studimeve me sukses të lartë, pikërisht viti i parë, dhe njohuritë e fituara gjatë ligjëratave ti aplikojë në biznesin tim familjar dhe të kem rezultate pozitive

edhe aty. Po ashtu nga viti 2011, mendoj të jem pjesëmarrëse në ndonjë gare diturie që organizojnë studentët e UBT-së.

Alma Shehu



Vitin që po e lemë pas e kalova me shumë sfida të cilat po thua se të gjitha i kalova me sukses. Ndër sfidat më të rëndësishme ishin si përfundimi i shkollës së mesme me sukses të shkëlqyer, testi i maturës me një rezultat të dalluar dhe regjistrimi në fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinier në UBT.

Por, për vitin që do vjen unë gjithashtu pres të kaloj në sfida nga më të ndryshme si sukseset e mija do të doja më shumë në kuadër të marrjes së dijes në fakultet pra në UBT. Bursa do të ishte e mirëseardhur, mirëpo ajo çka e pres me shumë është suksesi në provime.

Alor Ejupi



Përveç përfundimit të studimeve të vitit të parë me sukses të lartë, planifikoje të

përvetësoj edhe gjuhën angleze, dhe gjatë pushimeve semestrale mendoj të lëvizim jashtë vendit në ato shtete ku flitet gjuha në fjalë. Po ashtu planifikoje, që të startoj më një biznes jo edhe të vogël, ku do punësohen jo vetëm familjarët e mi por edhe shoqëria ime e ngushtë.

Arlind Dina



Çka pres unë prej vitit 2011, është që studimet të ecin mbarë, normalisht me vullnet dhe vendosmëri, të kem një punë praktike në një kompani të fortë në vend, sepse fakultetin të cilin studioj medoemos duhet të realizoj edhe anën praktike. Tjetër do të doja të shtoja në ndonjë trajnim jashtë vendin ose vizitë në ndonjë kompani si p.sh MICROSOFT corporation ose GOOGLE sepse është kompania me motivuese në botë si dhe ndonjë post diplomim jashtë vendit.

Egzana Peja



Viti 2010 për mua ishte vit mjaft i suksesshëm, morra pjesë në gara në kuadër të shkollës mora dhe mirënjohje për këtë, si dhe isha mjaft aktive sa i përket

aktiviteteve shkollore, vlen të përmendet që shkollimin tim të mesëm po ashtu testin e maturës i kalova me sukses të shkëlqyeshëm. Po ashtu në kuadër të aktiviteteve të lira korra mjaft sukses isha pjesëmarrëse në disa trajnime, konferenca, debate po ashtu ligjërova një nga trajnimet gjithsesi u certifikova për të gjitha këto.

Ajo çka pres nga viti 2011 është suksesi në UBT, të arrij të marr bursë pse jo, kurse sa i përket aktivitete të lira në kuadër të OJQ-ve nuk mendoj se do të jem mjaft aktive për arsye se është viti i parë në universitet dhe dua ta kaloj me sukses të dalluar.

Betim Biba



Gjatë vitit 2010 kam pas sukseset të mira, një ndër të arriturat ishte mbarimi shkollës së mesme me sukses të shkëlqyeshëm, po ashtu edhe mbarimi i testit kombëtar me një arritje të mirë, dhe fillimi i një jete të re studentore në Universitetin për Biznes dhe teknologji (UBT).

Ndërsa prej viti 2011 pres një sukses aq sa punoj, të përfundoj provimet me afat dhe me nota të larta, po ashtu edhe të udhëtoj jashtë shtetit me qëllime universitare.

Diellza Berisha

Vitin 2010 mund ta konsideroj si një vit të suksesshëm për mua sepse gjatë këtij viti kam kaluar disa sfida të lodhshme por shumë të rëndësishme! Klasa e XII fillojë me ekskursionin në Shqipëri, një periudhë e shkurtër por e paharruar, dhe pastaj vazhdoj me mësimet si dhe përcaktimin tim definitiv për atë se çfarë do



të studioj në të ardhmen, vendim ky i shqyrtuar me kujdes të veçantë. Pas orientimit për fushën e studimit pikësynim i imi ishte të mësoja intensivisht në mënyrë që ta kaloja testin e maturës me sukses, gjë të cilën edhe e arrita, përgatitja për testin pranues në fakultet ishte gjithashtu objektive parësore e cila më vonë mu shpërblye për të mirë, gjë që më bëri shumë të lumtur.

Në fund mund them me bindje të plotë se ky vit ka qenë vit i realizimit të aspiratave të mia dhe njëkohësisht mund ta quaj si vit i suksesit, kurse për vitin në vijim pres që të vazhdoj me punë të zellshme në studime, bashkëpunim me koleget e mi si dhe shkëmbim të ideve, e një udhëtim jashtë vendit qoftë për qëllime studimi apo argëtimi do të ishte shumë me vend!!!.

Fatos Shala



Plani im është të jap kontributin tim të kryej provimet me afat dhe të kem një sukses

të mirë gjatë këtij viti të parë universitar dhe të fitojë bursë. Për mua është nder, krenari dhe privilegj që jam pjesë e UBT-së. Sa për fund, stafit menaxhues dhe akademik në UBT ju uroj punë të mbarë dhe suksese gjatë vitit 2011, po ashtu UBT-së i dëshiroj planeve në vitin 2011.

Mehmet Vatovci



- Arritjet e mia në vitin 2010 kanë qenë të shumta. Disa prej tyre kanë qenë vizitat e mija në vendeve të ndryshme të Kosovës dhe Shqipërisë.

Në këtë vit jam marrë me disa aktivitete sportive, por më shumë me futboll.

Në këtë vit arritja më e madhe ka qenë regjistrimi në Universitetin UBT në drejtimin Shkenca Kompjuterike. Në vitin 2011 pres që ta përfundoj vitin e parë me sukses, dhe të vizitoj vende të ndryshme jashtë Kosovës e veçanërisht Italinë, me qëllim njohjen e kulturave të ndryshme të shteteve Evropiane.

Milot Fejza



Planet e mia personale të vitit 2011 janë si vazhdimi i studimeve me angazhim të madh për të marrë njohuri të shumta, të cilat mendoj se jetën time do ta ndryshojnë për së miri. Por mos ta harroj edhe situatën politike e cila po mbretëron në Kosovë, në një mënyrë është e rëndë e cila na kushtëzon në disa sfera, gjë shpresoj që nuk do të na përcjellë në vitin e ardhshëm. E rëndësishme për mu ka me qenë koha të cilën do t'ia kushtoj vetës por edhe moto e pandalshme ta përcjelli të studentët e gjeneratës time që kështu të veprojnë. Dhe për fund, urime të përzemërta festat e fund vitit, e posaçërisht atyre që janë pjesë e UBT-së, se në vitin që po hyjmë të na gjejë të gjithëve mirë dhe shëndosh.

Anketoi : Lirigzona Morain dhe Lavdim Menxhiq, studentë në UBT

Anketë me studentët e Fakultetit Juridik në UBT

Si vendosët të studioni në UBT më saktësisht Shkencat Juridike?

Të anketuarit tanë thonë se UBT ofron kushte dhe mësim cilësor, ofron praktikën mësimore nëpër institucione brenda dhe jashtë vendit, ka një numat të madh të marrëveshje ndëruniversitare në botë për shkëmbimin e stafit dhe të studentëve, shumica e të diplomuarve në UBT sot janë të punësuar nëpër kompani më të mëdha në vend dhe jashtë vendit, dhe në institucione shtetërore. Këto ishin arsyet dhe qëllimet e të anketuarve tanë si dhe pse kanë vendosë të studiojnë në UBT.



Majlinda Hajrizi

Duke u nisur nga fakti, se të gjithë dëshirojmë një studim sa më të mirë dhe më cilësor për formimin e personalitetit tonë, dhe duke e parë që UBT është universiteti më i miri privatë në vend, vendosa të studioj në universitetin në fjalë, në Fakultetin Juridik. Me këtë po bindem çdo ditë e më shumë se me të vërtetë kam bërë zgjidhje pozitive.

Unë dhe kolegët e mi jemi shumë të lumtur që jemi gjenerata e parë që studiojmë në Fakultetin Juridik në UBT.

Izet Hyseni

Arsyeja pse kam zgjedh të studioj në UBT është sepse në këtë universitet janë kushtet e mira për studime dhe stafi akademik është i nivelit më të lartë që ka ndonjë universitet në vendin tonë. Është fakultet me ambicie shumë të mëdha për ardhmen tonë. Unë si student dua të fitoj gjithçka që

është e mundur në profesionin tim nga ky fakultet që ti ndihmojë vendit tim në të ardhmen. Mendoj në të ardhmen të bëhem një jurist profesional, dhe UBT do mburret me kuadrin që ka shkolluar deri më tani, kuadro profesionale në profesione të ndryshme.

Faton Hyseni

Arsyeja pse unë kam zgjedh UBT është se do ta gjeja vetën më së miri se gjetiu. Para se të regjistrohem në fakultet kam shikuar ueb sajtin e UBT-së dhe kam pa shumë ngjashmëri me universitete që janë më famë botërore. Sa i përket juridikut e zgjedha këtë drejtim sepse arsyet ishin të mjaftueshme, pasi që kisha një lloj prirje për të dhe mundësia e përhapjes së këtij profesioni çdo ditë e më shumë në vendin tonë. Mbetem me shpresë që do të kem një të ardhme të ndritur dhe do të vazhdoj deri në fund të studimeve në UBT.

Doruntina Ismaili

Mendoj se pa qenë i shkolluar në nivel të duhur nuk mund të bësh edhe një jetë të mirë dhe të lumtur, dhe që prejse në moshë të re kam menduar edhe për shkollim universitar. Përfundova maturën me suksese të larta, dhe fillova të shikoj veb sajtet dhe publikimet që bënin universitetet nëpër media vendore, dhe me fillim klasifikova dhe vendosa për UBT. Dhe sot jam në vitin e parë në Fakultetin Juridik.

Besarta Demiraj

Qëllim im që kam hyrë në UBT, në Fakultetin Juridik është, sepse të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet në UBT janë sot të punësuar nëpër kompani të mëdha në vend dhe jashtë vendit, po ashtu ata të cilët kanë dashur të vazhdojnë studimet jashtë vendit janë pranuar pa problem dhe sidomos nëpër universitete më të forta të botës. Dhe mendoj se

pas përfundimit të studimeve themelore edhe unë do ta ndjek rrugën e tyre ose në punësim ose vazhdimin e studimeve jashtë vendit përmes UBT-së.

Vjoll Zenelja

"Zgjidh më të mirin që të bëhesh më i miri", kjo ishte fjalia që më ka tingëlluar më së shumti gjatë hapjes së konkursit të universiteteve private nëpër mediat vendore. U interesova për të gjitha konkurset, por në fund vendosa ta zgjedh universitetin më të mirë, UBT-në. Siç e kam vërejtur vullneti i menaxhmentit të UBT-së është për të na bërë neve sa më profesional në lëmi që po studiojmë, dhe mendoj se pas përfundimit të studimeve në UBT do të dal një juriste profesionale.

Anketoi: Veprim Mustafa studentë në UBT

Në UBT prezantohet shkenca

Menaxhmenti i lartë i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), ka përpiluar dhe aktivizuar projektin "Academic speech". Projekti ka për qëllim që stafi akademik dhe studentët të prezantojnë punën dhe hulumtimet e tyre

shkencore para kolegëve dhe miqve që kanë. Prezantimet shfaqen brenda objektit të UBT-së dhe të drejtë prezantimi kanë vetëm ata të cilët janë pjesë e universitetit.

Në semestrin e parë të vitit akademik 2010 - 2011, janë

paraqitur këta kandidatë me punën e tyre hulumtuese si Prof. Dr. Musa Limani, Dekani i Fakultetit Menaxhemnt, Biznes dhe Ekonomi, Lulëzim Beqiri, ligjërues dhe menaxher Zyrës për Projekte dhe Trajnime, Eleanor Pritchard, Skender Konushevi,

Sekretar i UBT-së, Murat Retkoceri menaxher për IT, etj.

Hulumtime e prezantuar në një të ardhme të afërt priten të botohen në revista të nivelit të lartë shkencorë përmes UBT-së.

Po ashtu gazeta "UBT News", në vazhdimësi do i përcjellë dhe

do i paraqes punimet e kandidatëve dhe atë vetëm si informata mbi prezantimin.

Koordinimi për prezantimin e hulumtimeve bëhet përmes dhe në bashkëpunim me liderin e projektit ose Zëvendëspresidentin D. Shields.

Procesi i privatizimit në Kosovë dhe efektet e tij

Prof. Dr. Musa Limani

Siç dihet, Kosova pas vitit 1999 gjendet në fazën e tranzicionit, e cila ballafaqohet me probleme të shumta politike, shoqërore, ekonomike, sociale etj. Ky proces është specifik për Kosovën, në krahasim me vendet e tjera, që e kanë kaluar fazën e tranzicionit, apo gjendet ende në këtë fazë. Në këtë fazë, Kosova (deri në pavarësinë e saj) është ballafaquar me dy veçori kryesore, siç janë: udhëheqja administrative e KB nëpërmjet UNMIK-ut dhe përkufizimet e kompetencave të institucioneve të qeverisjes së përkohshme vendore. Që të dy këta faktorë kanë paraqit problem në vete për tejkalimin sa më të suksesshëm të kësaj periudhe, veçmas elementeve të saj, duke shpëputur në veçanti procesin e privatizimit.

Në periudhën e tranzicionit, privatizimi zë vend dominues, i cili njëherazi praqet edhe hallkën kryesore dhe domosdoshmëri për kalimin e kësaj faze. Shtylla IV si bartëse e vetme e politikave zhvillimore makroekonomike në vitet e para të pas luftës, e shtroi si detyrë kryesore procesin e privatizimit, i cili pa kurrfarë rezerve u përkrah nga të gjitha strukturat politike e institucionale dhe ekspertët vendor. Mirëpo, edhe për rreth kësaj, procesi i privatizimit filloi me një vonesë prej afër katër vitesh.

Hapat e parë në fushën e privatizimit Shtylla IV i bëri me hartimin e dokumentit "Strategjia e zhvillimit të ndërmarrjeve", ose si quhej ndryshe "Letra e bardhë", të nxjerr në vitin 2000. Dokumenti në fjalë, nuk e pa dritën për shumë arsye, e për t'i përmendur janë: reagimi i faktorit ndërkombëtar (për këtë dokument shumë ashpër reagoi Kina dhe Rusia, si anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, duke potencuar se privatizimi i shpejt, prejjudikon pavarësinë e Kosovës), për çka erdhi edhe deri te disa ndryshime kadrovike në kuadër të Shtyllës IV. Shtylla IV si bartëse e vetme e politikave zhvillimore, në vend që të vazhdojë jetësimin e këtij dokumenti, ajo nxori vetëm disa segmente nga ai, dhe, kështu bëri gabim strategjik në fillimin e procesit të privatizimit, duke zbatuar for-



mën e dhënies me qira dhe komercializimin në ndërmarrjet në pronësi shoqërore. Qarqet profesionale e shkencore vendore, me kohë reagan kundër kësaj forme. Në praktikë këto forma nuk dhënë rezultate të pritura.

Me qëllim që të fillojë procesi i privatizimit, Shtylla IV themeloi Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit (AKM) në vitin 2002. Ndërkaq, pas nxjerrjes së Rregullores për transformimin e të drejtës së përdorimit të pronës të palëvizshme shoqërore në vitin 2003, faktikisht filloi procesi i privatizimit në Kosovë. Ky moment ishte një ngjarje e madhe dhe një gëzim për të gjithë punëtorët dhe popullatën e Kosovës, sepse mendohej se privatizimi do të ndryshojë gjendjen kaotike ekonomike e sociale, do të bëjë reforma ekonomike dhe do të krijoj kushte për zhvillim perspektiv të ekonomisë së Kosovës. Në fakt kështu duhej të ishte, sepse privatizimi nuk duhet kuptuar proces që ndryshon pronësinë, por që sjell reforma. Për fat të keq ky proces nga bartësit e privatizimit u kuptua si kalim i pronës shoqërore në atë private. Duke mos elaboruar më tepër, mendojë se procesi i privatizimit në Kosovë i udhëhequr nga AKM-ja është ballafaquar me tri sfida kryesore: me bartësit, me modelin e procesit të privatizimit dhe me fondin e mjeteve të privatizimit.

Sipas Rregullores 2000/12, AKM-ja paraqitë institucionin e vetëm dhe të pavarur që të udhëheqë me të gjitha fazat e procesit të privatizimit, dhe njëherit të menaxhojë me tërë ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe publike. Ajo

kishte të gjitha ingerencat për shpalljen e tenderëve, shitjen dhe likuidimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Për punën dhe veprimtarinë e vetë, i përgjigjej vetëm Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB. Nga kjo nuk është vështirë të konstatohet se, AKM-ja paraqitë "mini" qeveri, apo më mirë me thënë qeveri mbi qeveri, sepse për punën e vet nuk i përgjigjej asnjë institucioni vendor. Në që në fillim e kemi kundërshtuar këtë mënyrë të veprimit, duke potencuar se është e pa pranueshme nga aspekti profesional që një institucion me afat të kufizuar veprimi të udhëheqë një proces shumë të ndërlikuar: politik, shoqëror, ekonomik, social etj., siç është procesi i privatizimit.

Zgjedhja e modelit paraqet njëherë ndër çështjet më të ndryshme dhe më të rëndësishme në procesin e privatizimit. Vendet të cilat e kanë kaluar këtë proces kanë përdorur modele të ndryshme. Të drejtën e përcaktimit dhe zgjedhjen e modelit të privatizimit në Kosovë, e kishte vetëm UNMIK-u, përmes AKM-së, me ç'rast ofroi vetëm një model Spin-off, i cili ishte i rregullt dhe special dhe likuidimin. Sipas modelin Spin-off të rregullt, blerësi nuk mbante kurrfarë përgjegjësie për punëtorët që kanë punuar më parë në ndërmarrjen shoqërore (të shitur). Ndërkaq, me Spin-off special diç ishte më ndryshe, sepse këtu blerësi obligohej të ketë biznes plan ku pos investimeve të caktuara detyrohej të mbante dhe numrin e caktuar të të punësuarve. Sipas rezultateve të deri tashme

në procesin e privatizimit, me të drejtë mund të konkludohet se, as Spin-off i rregullt e as ai special nuk dhënë rezultatet e pritura.

Me mjetet e grumbulluara me rastin e shitjes së ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë është formuar vetëm një fond. Me këtë rast në vendet e tjera, janë formuar fonde të ndryshme, ku me ligj paraprakisht është përcaktuar destinimi i tyre, si: për zhvillim ekonomik, për punëtorë, pensionistë, invalidë etj. Kjo nuk ndodhi në Kosovë. Çka është edhe më e keqja se mbajtja dhe qëllimi i përdorimit të këtyre mjeteve nuk dihet, vlera e të cilave arrin diku afër 500 milionë euro. Në kontekst të kësaj mund të themi se, pos të tjerash, shitja e ndërmarrjeve shoqërore u bë me çmime shumë të ulëta. Thuaja se e tërë ekonomia e Kosovës u shitë për 500 milionë euro, kurse vetëm Kombinati i duhanit në Nish (Serbi) është shitur mbi 500 milionë euro. Këto mjete janë të ekonomisë së Kosovës, dhe normalisht se ato duhet të jenë në sistemin bankar të Kosovës dhe në funksion të zhvillimit të biznesit vendor. Për mos kthimin e këtyre mjeteve në sistemin bankar të Kosovës, si dhe të mjeteve të Trustit të pensionistëve etj. përgjegjësia bie mbi Qeverinë dhe Bankën Qendrore të Kosovës.

Sfidat me të cilat është ballafaquar procesi i privatizimit gjatë udhëheqjes së AKM-së janë: mungesa e ligjit për privatizim, mos përfshirja e punëtorëve në hallkat e privatizimit, ndërprerja e shpeshtë, anulimi i tenderëve në mënyrë arbitrare dhe neglizhenca në procesin e

privatizimit nga AKM-ja, prolongimi i nënshkrimit të kontratave me blerësit e ndërmarrjeve të shitura, mospërbushja e obligimeve ndaj punëtorëve të ndërmarrjeve të shitura, pra mospagesa e 20,0% që u takon punëtorëve sipas Rregullores, ndërrimi i destinimit të veprimtarisë, nuk dihet vlera e saktë e mjeteve të fondit, destinimi dhe mbajtja e mjeteve të fondit të privatizimit, privatizimi u bë burim (fole) kryesore e korrupsionit, i largimit të punëtorëve nga puna dhe sfida kryesore e shkatërrimit të ekonomisë së Kosovës.

Në fund duke e përmblytur këtë vlerësim të shkurtër për procesin e privatizimit, e duke u bazuar në modelin, formën dhe politikat operacionale dhe rezultatet e arritura në privatizim nëpërmjet AKM-së, me të drejtë mund të konstatohet se, ky proces ishte jo efikas dhe në dëm të klasës punëtore dhe ekonomisë së përgjithshme të Kosovës dhe si i tillë mund të themi se ishte dështim i plotë. Gjatë udhëheqjes së AKM-së me procesin e privatizimit u bënë shumë abuzime, kurse për t'i humbur të gjitha keqpërdorimet e bëra, me kalimin e mandatit të AKM-së nuk u bë dorëzim pranimi i dokumentacionit me Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP), u tentua të asgjësohen të gjitha dokumentet përmes djegies së tyre, për të cilën deri më tani askush nuk dha përgjegjësi. S'ka dyshim se ky akt vandal na shpie deri te konstatimi se në procesin e privatizimit i udhëhequr nga AKM-ja ka pasur shumë keqpërdorime e abuzime të llojeve të ndryshme. Andaj, Agjencia Antikorrupsion dhe Auditori Qendror duhet të bëjnë rivlerësimin e të gjitha ndërmarrjeve të shitura ku dyshohet se janë bërë abuzime dhe keqpërdorime, të hulumtojë prejardhjen e pasurisë së individëve dhe t'i vejë par ligjit të gjithë ata që e kanë fituar në mënyrë jo ligjore, pa marrë parasysh kush është dhe çfarë posti kishte dhe tani ka në institucione e struktura shtetërore dhe partiake.

Autori është mësimdhënës dhe Dekan i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, dhe Drejtor për Studime Ekonomike në UBT

Ligjëratë për Menaxhimin strategjik



Prishtinë, 10 dhjetor 2010 –

Menaxheri i Departamentin për Projekte dhe Trajnime në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Lulzim Beqiri, para studentëve dhe stafit të UBT-së mbajti një prezantim për aktivitetet e tij hulumtuese në fushën e Menaxhimit Strategjik.

“Hulumtimet janë të orientuara në fushën e Menaxhimit Strategjik dhe kryesisht për fokus kanë kompanitë e mesme dhe të vogla ndërtimore të Kosovës”, tha z. Beqiri, i cili më tej shtoi se, hulumtimi në fjalë ka të bëjë me pasqyrimin e gjendjes momentale dhe reale të kompanive ndërtimore në Kosovë në fushën e menaxhimit strategjik. Ai ceku edhe arsyet e fokusimit të hulumtimit, të cilat janë: vazhdimi i hulumtimit nga niveli i studimeve Master në UBT, më

saktësisht në Departamentin IEME, eksplorimi i lëmisë së Menaxhimit Strategjik, analiza e nivelit të zhvillimit të kompanive ndërtimore në Kosovë dhe ofrimi alternativave për zhvillimin e menaxhimit strategjik të kompanive të mesme dhe të vogla ndërtimore në Kosovë.

Gjatë prezantimit përmendi edhe tre metoda të hulumtimit që do të përdoren për të realizuar këtë punim, metoda që kanë treguar sukses dhe që janë të përshtatshme për natyrën e hulumtimit e ato janë: Direkt-intervistë me kompanitë ndërtimore-pyetësorët, indirekte-mbledhja e të dhënave nga institucionet përkatëse si ministrat dhe komunitat, dhe mbështetje-interneti, profesorët, kolegët etj.

Pjesëmarrësit e vlerësuan lartë prezantimin e z. Beqiri dhe më pas debatuan për temën në fjalë.

Ligjëratë për Sistemin Politik në Zvicër

Prishtinë, 17 dhjetor 2010

Sekretari i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), z. Skënder Kunushevcu, para studentëve të Fakultetit Juridik dhe stafit të UBT-së mbajti prezantimin e tij me titull: Sistemi Politik në Zvicër, nga lënda: Sistemet Kushtetuese Krahasuese.

z. Skënder Kunushevcu paraqiti hulumtimin e tij të realizuar në studimet Master pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në drejtimin Kushtetues Administrativ, me mentor Prof. Dr. Arsim Bajrami. Në këtë

prezantim, ai fillimisht paraqiti historikun e krijimit të Zvicrës, pastaj u ndal veçmas në pasqyrimin e sistemit kuvendor (bikameral) të Zvicrës, të përbërë prej dy dhomave, zhvillimin e sovranitetit të kantonëve në shtetin federal të Zvicrës dhe funksionimin e demokracisë së drejtpërdrejt në Zvicër, duke iu falënderuar traditës demokratike dhe kulturës së zvicëranëve.

Studentët e Fakultetit Juridik të UBT-së dhe pjesëmarrësit e tjerë e vlerësuan lartë prezantimin e Skënder Kunushevcit dhe më pas debatuan për temën në fjalë.



Ligjëratë për kompjuterin dhe zhvillimin e tij



Prishtinë, 24 dhjetor 2010 -

Menaxheri për IT në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Murat Retkoceri, para studentëve dhe stafit të UBT-së mbajti prezantimin e tij hulumtuese nga fusha dhe periudhat historike të kompjuterit në botën e zhvilluar.

Gjatë ligjëratës, z. Murati, përmendi zhvillimin e hovshëm të kompjuterëve ndërsa si krahasim bëri periudhën e viteve 1960 dhe 2010, ku në vitet e 60 – ta, sipas tij, gjendeshin 16 kompjuter në gjithë botën

ndërsa, sot, më 2010, llogariten të jenë gjithsej 1.8 miliard shfrytëzues të kompjuterëve dhe natyrisht edhe të sistemeve operative.

z. Murati përmendi të gjitha zhvillimet e rëndësishme duke iu referuar datave ekzakte të ndodhive të tyre dhe gjithashtu edhe personave përgjegjës për krijimet e tyre. Ai bëri krahasime duke filluar nga madhësia e kompjuterëve të parë, çmimeve nëpër periudha të ndryshme kohore, se si bashkërisht ato shkonin duke u zvogëluar.



Xella Kosova Ju uron festat e fundvitit.

www.xella.com




XELLA KOSOVA LLC

Bukuri e pastër! E tëra në të bardhë, me tullat e fasadës Silka shtëpia juaj do të shkëlqejë!

Në natyrën e secilit njëri është që të arrijë të ndërtojë shtëpi, shtëpi të cilën paraprakisht e imagjinojnë se si do të duket secili segment i saj, sepse secili prej nesh dëshiron që të krijojë pamje sa më tërheqëse, të qëndrueshme në kohë, komode për banim për familjen dhe njëkohësisht të jetë e pëlqyer nga të tjerët.

Tanimë faza emergjente e ndërtimit në Kosovë ka kaluar që moti, dhe me këtë kriteret dhe kërkesat për materiale sa më cilësore janë në rritje sepse investitorët e shtëpive po dëshirojnë që të ndërtojnë edhe për gjeneratat që vijnë.

Krahas ndërtimit të shtëpisë dhe investimeve në hapsirët e mbrendshme për banim rëndësi po i kushtohet edhe pamjes së jashtme në kuptimin e izolimit termik, pamjes tërheqëse dhe njëkohësisht qëndrueshmërisë afatgjatë.

Për një fasadë cilësore, elegante dhe të qëndrueshme për sot dhe të ardhmen e familjes tuaj, Xella Kosova ju ofron materialin më të mirë në tregë – tullat e fasadës Silka.



Fabrika Xella Kosova me seli në Lipjan (lexo: Xella Kosova është filialë e Xella International me seli në Gjermani) prodhon tullat e fasadës në 5 modele.

Nëse përcaktoheni për fasadimin e shtëpisë tuaj me tullat Xella Silka, ju jeni përcaktuar për një stil unik të shtëpisë tuaj, pra ju jeni përcaktuar që nga një shtëpi të zakonshme ta shëndr-

roni në shtëpi të ëndrrave tuaja.

Ska rëndësi se për cilin format ju përcaktoheni, ju do të mund të ndërtoni diçka të veçantë, sepse tullat e fasadës Silka japin mundësi për kreativitet si në pamjen e jashtme dhe të mbrendshme, me një fjalë ju mund të shprehni shijen tuaj individuale e cila do të lakmohet nga të tjerët.



Parametrat të cilat i karakterizojnë tullat e fasadës Silka janë:

- Elegancë dhe dizajnë
- Higjienik dhe shumë të shëndetshëm për banim
- Kursimi i energjisë
- Mbrojtja akustike
- Mbrojtja nga agjentët atmosferikë
- Termo-izolues
- Zjarr-qëndrues etj.

Prodhimet kualitative, elegante dhe shumë të shëndetshme prodhohen me teknologji Gjermane, lëndë të parë vendore (rërë kuarci, gëlqere dhe ujë), dhe staf të trajnuar në Gjermani. Këto produktet janë në tregë, andaj mos e lëshoni rastin për një pamje mahnitëse të shtëpisë suaj.

Si të shikohet një film?!



Dr. ILIR MUHARREMI

Filmi është një përjetim i thellë subjektiv, një pikturë lëvizëse, me një protagonist negativ apo pozitiv. Sot, me të drejtë, kultura është ndër problemet më të rëndësishme shoqërore, por asnjëri nuk po i shkon në mëndje se midis shumë shkencave të artit mungon dukshëm estetika kinematografike. Nëpër shumë universitete tona ekzistojnë fakultete për letërsinë dhe artet tjera,

por nuk ekziston as edhe një katëdër mbi artin e ri kinematografik. Kur them nuk ekziston me këtë nënkuptojmë, krijimin e vlerave të mirëfillta dhe prodhimin e gjeneratave të shëndosha, të cilët me talentin e tij do na shpajnë me këtë art kinematografik. Qysh nga shkollat e mesme, flitej pothuajse për çdo art, për kinematografinë jo. Miliona njerëz studiojnë estetikën e letërsisë e të pikturës pa perspektivën se do t'i zbatojnë ndon-

jëherë njohuritë e marra apo të lexojnë një libër ose të sodisin ndonjë kuadër. Të gjithë këta shikojnë çdo natë kinema. Me paditurinë e tyre gëlltisnin gjithçka që u servilet. Duhet të stërviten, si të shikojnë film, si ta pranojnë tematikën, ritmin, fotografinë, lojën e aktorëve, kulturën krijuese, planet etj. Regjisorët janë mësuar, të shkruajnë vet, të udhëheqin në tërësi këtë art vet, ngase janë të obliguar, sepse konceptet e tyre krijuese, janë të padukshme për regjisorët profesionist. Tekst shkruesi, është i obliguar të futet në malin e regjisë, edhe pse mund të hasë në një mal të rrezikshëm, ai fare nuk frikohet nga kjo, sëpata e tij nuk është shumë e mprehtë. Andaj, nëpër ekranet e kinemave tona, filmat vendorë pak kanë fuqi të futen mbi shpirtin e masave të pranuesve të mesazheve. Filmin nuk duhet vetëm ta shohin, por edhe ta kuptojmë. Por, që ta kuptojmë duhet të pajisemi me disa njohuri të veçanta të cilat do të na japin një farë orientimi edhe një njësi matjeje, në mënyrë që të mos jemi të detyruar t'i dorëzohemi

pa kushte. Regjisorët, dhe ne si publik, duhet t'i njohim ligjet dhe mundësitë e artit kinematografik për të qenë në gjendje të kontrollojmë e të disiplinojmë ndikimin shpirtëror që ushtron ky lloj arti pa pararendës në historinë e qytetërit njerëzor. Skenaristët, duhet të frymëzohen nga temat reale, problematikat e thella shqetësuese, e jo ta kërkojnë absurdin, pa përformuar në realen. Tek ne shumë filma të dështuar janë prodhuar pas luftës, asnjëri nuk ka pasur magji t'i shpojë veshët dhe sytë e shikuesve, ose t'i mashtrorë ata me një temë të imagjinuar, ose reale. Vlen të cekët një film, sepse e meriton të quhet film "Kukum" i regjisorit Isa Qosja. Aty ka kulturë krijuese, publiku has në shije. Imazhi i jep trajtë zërit, ndërsa heshtja e cila është pothuajse si një mbret i këtij filmi, është me efekt akustik, përbëhet nga efektet dramatike origjinale të këtij filmi zanor. Kam vetëm një vërejtje të vockël rreth tregimit të filmit, kthimin e personazheve sërish në çmendi. Ata nuk mund të lirohen nga problemi psikik, dhe kthimi tregon si një

problem të pazgjidhur të tyre. Mungon ndonjë personazh më harmonik, ose më i lumtur, sepse ku është pesimizmi, aty rrënjët i ka edhe optimizmi. Por, sipas të gjithave është i vetmi film Kosovar që bart me plotë vlerë epitetin film. Në anën tjetër filmi "Anatema" i regjisorit Agim Sopit, më shumë është punuar në fotografi sesa në vijë dramaturgjike, konkretisht në skenar dhe në përmbajtje të tij. Skenari nuk është vetëm një mjet ndihmës teknik, nuk është si një skelë që mund të çmontohet sapo shtëpia të jetë ndërtaur, por është një formë letrare e denjë për penën e poetit që mund të botohet edhe si libër me vete. Në fillim regjisorit ka qenë edhe autor, dialogët shkruheshin pas montimit dhe i jepeshin spektatorit për t'u lexuar në kuadro të veçanta. Andaj, tash në këtë kohë ekziston skenaristi, dhe regjisorit zbulon sekretin e personazheve, nuk i krijon ai, por i mishëron dhe i vë në lëvizje të arsyeshme. E te filmi "Anatema", personazhet ende duhet të plotësohen që të mos ndeshën me gabimet.

NATO ka ende punë për të bërë në rajonin e Ballkanit Perëndimorë

Nëntor, 2010 - Ashtu siç është e ditur më datën 19 dhe 20 nëntor, në Lisbonë të Portugalisë është mbajtur Samiti i NATO-s me pjesëmarrjen e të gjithë krerëve të shteteve anëtare të NATO-s, duke përfshirë edhe Presidentin Amerikan, Barack Obama. U diskutua gjerë e gjatë lidhur me prezencën e NATO-s në Afganistan, vendosjen e sistemit anti-raketor në Evropë. Samiti gjithashtu aprovoj konceptin strategjik të ri të NATO-s për dekadën e ardhshme për përbashkë dhe objektivin për të garantuar paqe e liri në Evropë.

Paralel me samitin e krerëve të shteteve anëtare të Aleancës Veri-Atlantike të NATO-s, u mbajt edhe samiti Atlantistëve të rinj si lider të së ardhmes së NATO-s. Në këtë samit nga Kosova ishte vetëm një përfaqësues, pikërisht ligjëruesi i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), z. Emrush Ujkani. Profesor Ujkani, ishte ftuar në cilësinë e udhëheqësit të Institutit për Studime Evropiane pranë UBT-së, si dhe në cilësinë

e ekspertit nga Ballkani Perëndimor për çështjet Euro-Atlantike. Në të njëjtën kohë ai ishte ftuar të jetë pjesë e panelit me temën "Si mundët NATO të mbështesë stabilitetin politikë dhe integrues të vendeve Ballkanit Perëndimor?". Në paraqitjen e tij para të pranishmeve z. Ujkani ndër të tjera theksoj se NATO ka ende punë për të bërë në rajonin e Ballkanit Perëndimorë, duke mbështetur vendet e këtij rajoni që të forcojnë rendin dhe stabilitetin politikë si garancë për zhvillimin ekonomik dhe përmeshjen e kritereve integruese për anëtarësim në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ai më tutje theksoj se NATO, veçanërisht duhet të fokusohet në modernizimin e forcave të mbrojtjes të këtyre vendeve madje ai mori si shembull të veçantë mbështetjen që NATO po ofron në ngritjen dhe forcimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu ai përmendi faktin se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë dhe misioni i saj atje vazhdon të jetë ngjarja më e suksesshme në gjithë kurrikulumin e historisë së ekzistimit të kësaj organizate.

I pyetur nga të pranishmit se si e sheh të ardhmen e Kosovës dhe të Serbisë, z.Ujkani theksoj se për të ardhmen e rajonit të Ballkanit Perëndimor në

përgjithësi ekziston vetëm një e ardhme dhe ajo është integrimi në familjen e madhe të Bashkimit Evropian. Më tutje ai shtoi se " Kosova dhe Serbia dalëngadalë po mësohen të jetojnë si dy shtete të pavarura përkundër retorikës së përdorur nga Beogradi.

Gjithashtu në një pyetje provokative të shtruar nga një student portugezë i cili merrej me studime të çështjeve të Ballkanit Perëndimor. Se sa e vështir është që të mendohet dhe të realizohet pajtimi në mes të dy popujve atij të Kosovës dhe Serbisë?, Profesor Ujkani me elokuenca dhe në mënyrë diplomatike dhe gjithsesi akademike ju përgjigj duke theksuar se një gjë duhet të definohet dhe kuptohet çartë qysh në fillim se Kosova dhe populli i saj ishin viktive e politikës së diskriminuese dhe shfarosëse të diktatorit

Slobodan Miloseviç gjë që edhe detyroj intervenimin e NATO-s në atë që do quhej mission humanitar. Por kur flasim për të ardhmen dëshiroj ti referohem një shembulli shumë të veçantë i cili është treguar të jetë i suksesshëm dhe i cili ka ndodhë në Evropë. "Ju si shtetas i një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, me lejoni të ju rikujtoj një gjë, kur ish Ministri i Jashtëm Francez z. Robert Schuman i cili edhe më të drejt konsiderohet njëri nga etërit e Bashkimit Evropian të sotëm, pas gatishmërisë së shprehur për tu pajtuar për nënshkrimin e traktati për Thëngjill dhe Çelik në mes Francës dhe Gjermanisë perëndimore me 9 Maj1950, i cili edhe doli të ishte hapi i parë drejt Evropës së bashkuar, ishte nën një trysni të madhe të opinionit Francez sepse kishin kaluar vetëm pesë vite nga përfundimi i luftës

së dytë botërore dhe për francezet bashkimi me Gjermaninë në një union të tillë nuk ishte e lehtë për tu kapërdirë. Ish ministri Francez do tu përgjigjej francezëve dhe kritikave të tjerë me këto fjale citoj "Ne ua shtrijmë dorën armiqve tanë të djeshëm jo thjesht për ti harruar të bëmat e tyre, por që të ndërtojmë Evropën tonë të përbashkët". Rrjedhimisht unë besoj se në frymën e kësaj qasje edhe dy vendet tona dhe popujt respektive do gjejnë mundësin për të dëshmuar një shembull të tillë. Populli i Kosovës si viktive e kësaj te keqe natyrisht që pret kërkim faljen nga lidhshipi serb në emër të popullit serb dhe shqiptarët si popull tolerant nuk e kanë fare vështirë që të pajtohen për një të ardhme të përbashkët natyrisht pa harruar të këqijat që na janë bërë.

Gjatë qëndrimit në Lisbonë Profesor Ujkani pati mundësi të ketë takime të shkurtra edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s zotin Anders Fogh Rasmussen, ish zëdhënës e NATO-s z.Jamie Shea, Ministrin e Jashtëm të Slovakisë z. Mikuláš Durinda, Ministrin e Jashtëm të Bullgarisë, Nikolai Mladenov, Admiralin amerikan të forcave të NATO-s për Evropë James Stavridis si dhe takime me zyrtarë të tjerë.



UBT ua uron festat e fundvitit

